



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.3.2022, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Jorida Tabaku – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i raportit final i komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve”.

Marrin pjesë:

Jorida Tabaku, Ermonela Valikaj (Felaj), Antoneta Dhima, Anila Denaj, Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Eduard Shalsi, Besion Ajazi, Dhurata Tyli (Çupi), Belind Këlliçi, Lefter Gështenja, Luçiano Boçi, Helidon Bushati, Ina Zhupa dhe Denis Deliu.

Mungon:

Etjen Xhafaj.

HAPET MBLEDHJA

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Jemi mbledhur sot në mbledhjen e fundit të komisionit hetimor “Për hetimin e procedurave të tri impianteve të trajtimit të mbetjeve, në Tiranë, Elbasan dhe Fier”, ku do të parashtrijmë dhe prezantojmë raportet që kanë ardhur pas punës pothuajse tremujore të këtij komisioni.

Në fillim më lejoni që në emrin tim dhe të kolegëve këtu të shpreh urimet për festën e 7 Marsit për të gjithë mësuesit, pedagogët, por njëkohësisht në mënyrë të veçantë edhe për të gjithë kolegët deputetë, të cilët e ushtrojnë këtë profesion krahas punës së deputetit.

Unë e kam nisur karrierën time si pedagoge dhe besoj se të gjithë atje do të kthehemi në fund, pasi të mbarojmë me nder dhe dinjitet karrierat tona politike.

Duke treguar vlerësimin maksimal të përbashkët, që besoj se do të jetë pika e vetme e përbashkët e kësaj dite, përfaqësuesit e opozitës dhe të maxhorancës në këtë komision hetimor kanë përgatitur raportet e tyre paraprake, kështu që do të kemi një prezantim nga ana ime dhe një prezantim nga zëvendëskryetarja e komisionit, zonja Felaj.

Dua t’ju informoj që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka bërë një punë të jashtëzakonshme me një raport prej 120 faqesh, ku në pjesën e parë ka analizuar në detaje procedurat për dhënien e të tri impianteve të trajtimit të mbetjeve, në pjesën e dytë të tij është analizuar zbatimi i kontratave, kurse në pjesën e tretë është bërë një analizë financiare se ku kanë shkuar paratë.

Për këtë raport prej 120 faqesh kanë punuar një grup i jashtëzakonshëm ekspertësh ligjorë, mjedisi, auditi dhe kontabiliteti, të cilët dua t’i falenderoj, për të analizuar librat e shitjes dhe blerjes dhe për të kuptuar ku kanë shkuar paratë e këtyre tri impianteve.

Njëkohësisht, dua të falenderoj të gjithë deputetët e opozitës në këtë komision, duke filluar nga zoti Lefter Gështenja, zoti Luçiano Boçi, zoti Helidon Bushati, zonja Ina Zhupa, zoti Belind Këlliçi, zonja Dhurata Çupi dhe zoti Edmond Spaho, që fatkeqësisht iu largua komisionit dy javë më parë! Të gjithë kanë bërë një punë të jashtëzakonshme për të hetuar këtë aferë, punë e cila nuk është bërë vetëm këto katër muaj, por është bërë në vijim që nga viti 2014, kur zoti Boçi nisi denoncimet e para për insineratorin e Elbasanit.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Deputetët e opozitës parlamentare në komisionin hetimor parlamentar “Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative dhe procedurës së ndjekur nga ana e organeve ekzekutive në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane në Tiranë, Elbasan dhe Fier”, vlerësojnë se procedurat e ndjekura për ndërtimin e këtyre veprave publike janë në kundërshtim të hapur me legjislacionin shqiptar, përfshirë atë penal, të cilat kanë sjellë një dëm ekonomik që i rëndon buxhetit të shtetit me të paktën një vlerë prej 430 milionë euro.

Dokumentet dhe dëshmitë e administruara gjatë punimeve të këtij komisioni krijojnë bindjen se procedurat për ndërtimin e impianteve në Elbasan, Fier dhe Tiranë janë një aferë masive financiare, me një dëm mbi buxhetin e shtetit që llogaritet paraprakisht në rreth 430 milionë euro, por që në përfundim të afateve koncesionare është shumë më i lartë dhe me pasoja të drejtpërdrejta edhe për qytetarët.

Qëllimi ynë kryesor në ngritjen e këtij komisioni hetimor ishte të bënim të qartë me prova dhe fakte për qytetarët e Shqipërisë, atë që kemi denoncuar prej vitesh, kryerjen e një krimi shtetëror të vjedhjes së parave të shqiptarëve me anë të vënies në dispozicion të institucioneve qeveritare në nivel qendror dhe lokal një grupi të panjohur individësh me duar në xhepa, që propozuan projekte, të cilët e vetmja gjë që duhet të bënin ishin të merrnin përsipër arkëtimin e parave të buxhetit të shtetit për vete dhe për përfaqësuesit e qeverisë në krijimin e skemës më të madhe mashtruese dhe korruptive të zbuluar ndonjëherë në Shqipëri.

Kjo skemë kishte si qëllim vetëm marrjen e fondeve publike dhe mosndërtimin e insineratorëve, në mënyrë që të vazhdonte të mundësohej vjedhja galopante e parave të shqiptarëve. Qëllimi primar i këtij grupi që, në fakt, për qëllime të Kodit të Procedurës Penale, quhet “grup i strukturuar kriminal”, i përbërë nga përfaqësues të niveleve më të larta të qeverisjes qendrore, së bashku me stafet në varësi të tyre, duke filluar nga kryetarët e bashkive të përfshirë, por njëkohësisht edhe komisionet e koncesionit dhe njësitë e zbatimit të projektit, ka qenë lehtësimi i procedurave, shkelja e ligjit, zbatimi i kontratave korruptive dhe vazhdojnë akoma sot e kësaj dite të shkaktojnë dëm për buxhetin e shtetit.

Komitetet ndërministrare, që ndryshojnë kuadrin ligjor për të mundësuar krijimin e terrenit për veprimtarinë e këtij grupi, kanë qëllim të vetëm që me anë të mashtrimit, duke krijuar situata të pavërteta, duke shfaqur shenja të qarta të korrupsionit në çdo strukturë qeverisëse të përfshirë, të abuzimit me detyrën, të pastrimit të parave, që u janë marrë padrejtësisht taksapaguesve shqiptarë, kanë krijuar një skemë korruptive.

Afera financiare rezulton se është mbështetur në dy shtylla kryesore. E para, në përfitimin e kontratave koncesionare nga kompani të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën, pa përvojë, pa aftësi financiare, në shkelje të proceduarave në hartimin, miratimin dhe

zbatimin e këtyre kontratave koncesionare dhe, së dyti, në përfitimin e fondeve publike përmes një skeme pastrimi parash për t'i nxjerrë këto fonde jashtë vendit apo duke kryer pagesa me kompani fiktive, si dhe kompani që zotërohen nga të kërkuarit në arrati, Zoto, Gugallja dhe Mërtiri.

Zanafilla e aferës së insineratorëve do të ngjante e pakuptueshme nëse në këtë aferë, në këtë pjesë të parë të analizës, ne nuk do të ndaleshim te kompanitë që kanë përfituar tre projektet, në Elbasan, Fier dhe Tiranë dhe, mbi të gjitha, kush janë pronarët e këtyre tre kompanive. Faktet, dokumentet dhe dëshmitë tregojnë se, në fakt, janë gjithmonë të njëjtët njerëz, të njëjtat mekanizma, të njëjtat lidhje korruptive dhe praktika të paligjshme.

Pas analizës së një materiali prej 385 faqesh, të dorëzuar në këtë komision nga Qendra Kombëtare për Biznesin, është vërtetuar se formalisht pronarët e insineratorëve janë tre: Klodian Zoto, Stela Gugallja dhe në pak raste Mirel Mërtiri, por e vërteta është se kryepronari i vërtetë i këtyre insineratorëve është Mirel Mërtiri, shtetasi Klodian Zoto është vartësi i tij, kurse Stela Gugallja është bashkëjetuesja e tij. Ata kanë menaxhuar tri kontrata prej 430 milionë eurosh, duke u fshehur herë pas kompanive holandeze, herë pas dy kompanive italiane, e herë pas një kompanie malteze, por gjithmonë është i njëjti person që shfaqet.

Mirel Mërtiri, një person me të shkuar të dyshimtë dhe pa asnjë sukses të madh në sipërmarrjet e tij, papritur është bërë personi kyç në një nga bizneset më fitimprurëse këtu në Shqipëri dhe kudo në botë. Ai pati idenë brilante për t'i propozuar ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, ndërtimin e tre insineratorëve dhe ideja e tij jo vetëm u gjet shumë interesante për interesin publik, por të gjitha institucionet qendrore dhe ato vendore u vunë në dispozicion të tij për të implementuar gjetjen e shekullit, të cilën shumë vende e kishin refuzuar me vendosmëri për shkak të pasojave që prodhonte në mjedis dhe për shëndetin e njerëzve.

Tashmë kushdo mund të ketë ngritur pyetjen: si ka mundësi që shteti të vihet në shërbim të këtij individi? Dhe, në fakt, kjo është një pyetje e drejtë, sepse kur lexon aktet, dokumentet, dëshmitë, procesverbalet ti shikon se si funksionarë publikë, të cilët e kishin refuzuar me vendosmëri projektin, papritur reflektojnë dhe miratojnë.

Përgjigjja, në fakt, e komisionit hetimor, Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, medias dhe qytetarëve duhet kërkuar te faktet dhe lidhjet e këtij shtetasi me persona që mbajnë funksione të larta qeveritare. Njëri prej tyre rezulton të jetë deputeti, ish-ministri i Ekonomisë, ish-ministri i Financave, ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj. Faktet që do të paraqesim në vijim dëshmojnë për njohjen e vjetër dhe marrëdhënien e konsoliduar ndërmjet këtyre dy shtetasve me njëri-tjetrin, gjë e cila, në fakt, nuk është mohuar asnjëherë as publikisht.

Një lidhje tjetër e njohur dhe e vjetër është ajo mes ish-ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, deputetit dhe sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Socialiste, Damian Gjijnuri. Dyshja Ahmetaj-Gjijnuri duket sikur ka vënë në lëvizje të gjithë administratën shtetërore për të bërë atë që nuk e bëri asnjëherë Mirel Mërtiri në jetën e tij, por e bëri qeveria shqiptare: e transformuan atë në një nga biznesmenët më të mëdhenj e të fuqishëm në këtë vend. Kjo jo për zemërgjerësi, as për bujari, por për shkak të interesave korruptive dhe financiare që i lidhin këta shtetas me njëri-tjetrin.

Mundësitë e këtij komisioni hetimor për t'i shkuar më tej kësaj afere të vërtetë dhe të madhe, sigurisht, në disa raste kanë qenë të kufizuara dhe janë penguar, veçanërisht nga avokatët e aferës së inceneratorëve në këtë komision dhe jashtë këtij komisioni nga institucione publike, nga banka të nivelit të dytë.

Megjithatë, unë i kërkoj sot, në emër të opozitës, SPAK-ut të fokusohet dhe të hetojë lidhjet e këtyre personave, raportet e udhëtimeve të tyre jashtë Shqipërisë; të hetojë udhëtimet e përbashkëta që kanë realizuar këta shtetas; vendet ku kanë qëndruar, si dhe aktivitetin e tyre.

Kompanitë që kanë fituar kontratat koncesionare për ndërtimin e landfilleve dhe inceneratorëve në Elbasan, Fier dhe Tiranë, nuk kanë pasur asnjë përvojë në fushën e përpunimit dhe të incenerimit të mbetjeve urbane.

Kompanitë koncesionare, siç rezultoi nga dokumentet zyrtare, nuk kanë pasur as kapacitetet financiare për ndërtimin e këtyre tre impianteve, vlera operationale e të cilave përlllogaritet në pothuajse 150 milionë euro, pa përfshirë përfitimet e tjera nga shërbimi i depozitimit, i incenerimit të mbetjeve, prodhimi dhe shitja e energjisë, depozitimi i dherave të siguruara nëpërmjet kontratës koncesionare të monopolit, njëkohësisht përmes veprimeve dhe mosveprimeve të qeverisë qendrore dhe asaj lokale.

“Skema e tri kovave”, në fakt, kemi dashur ta quajmë mënyrën se si kanë funksionuar të tria kompanitë. Kompanitë koncesionare, me mbështetjen e plotë të autoriteteve shtetërore, kanë aplikuar një skemë të ngjashme që në termat ekonomike njihet si “tri kovat”; skema ka rezultuar e tillë.

Kompania Albtek Energy sh.p.k., e cila ka fituar kontratën e parë koncesionare për ndërtimin e landfillit të Elbasanit, nuk ka pasur mundësi financiare për ta ndërtuar këtë projekt me një kosto prej 3 miliardë lekësh pa TVSH. Pasi ka siguruar kontratën koncesionare, kompania Albtek Energy sh.p.k. ka aplikuar për kredi financiare (provë të cilën e kemi siguruar në këtë komision), duke përdorur si kolateral pikërisht kontratën koncesionare.

Paratë e marra me kredi, si dhe pagesat e kryera nga qeveria, janë përdorur nga kompania për të ndërtuar landfillin e inceneratorit të Elbasanit, me një vlerë pothuajse një të

tretën e asaj që kompania deklaroi sipas librave të shitjeve dhe të blerjeve të kompanisë, ndërkohë që kontrata koncesionare parashikonte që ndërtimi do të kryhej me shpenzimet e vetë kompanisë.

Një pjesë të parave të përfituara përmes kësaj skeme, kompania Albtek Energy sh.p.k. i ka shpërndarë për konsulencë te dy kompani të tjera, të zotëruara prej pronares së Albtek Energy sh.p.k. (ne kemi administruar si provë të gjitha pagesat). Të dyja këto kompani, ashtu siç kam edhe pagesat e faturave me TVSH, të dorëzuara në organet tatimore nga kjo kompani, i kanë marrë dy kompani të zotëruara nga Stela Gugallja dhe kompania tjetër konsulente nga zoti Klodian Zoto, një personazh që shfaqet gjerësisht në skemën e tre inceneratorëve.

Pjesa tjetër e parave publike janë shpërndarë për kompaninë ITS, që përsëri zotërohet nga Klodian Zoto.

Një pjesë e parave të përfituara, përveç atyre që kanë shkuar për ndërtimin e inceneratorit të Elbasanit, që është një e treta e vlerës, kanë shkuar jashtë Shqipërisë në transferime kapitali në destinacione të paditura për këtë komision. Kjo është një nga kërkesat e dyta që unë i bëj organit të akuzës për të vërtetuar se ku kanë shkuar këto para me transferim kapitali.

Sakaq, vihet re një diferencë e qartë mes vlerës së zhdoganimeve për impiantin e inceneratorit në kontratën e nënshkruar me furnizuesin italian, në vlerën 15 milionë euro, të cilën e kemi administruar si provë, dhe vlerës së zhdoganimeve për këtë impiant, i cili kushton vetëm 7,7 milionë euro sipas librave të shitjeve dhe blerjeve të kësaj kompanie.

Në Elbasan është ndërtuar i vetmi incenerator i mbetjeve, në fakt, një impiant i cili aktualisht nuk funksionon. Rezulton se autoritetet qeveritare nuk kanë kryer inspektim mbi realizimin dhe cilësinë e punimeve. Çdo gjë është bërë nga një supervisor i pavarur. Rolin e supervizimeve në impiantin e përpunimit të mbetjeve në Elbasan, ashtu si edhe në ata të ngjashmit në Fier dhe në Tiranë, e kanë kryer kompanitë e zgjedhura nga i njëjti rrjet biznesesh.

Në dokumentet zyrtare rezulton se asnjë autoritet shtetëror nuk e ka mbikëqyrur kurrë cilësinë e pajisjeve të përdorura për ndërtimin e impiantit apo edhe përputhshmërinë e tyre me standardet e nevojshme, njëkohësisht as për ndikimin e tyre në mjedis.

E njëjta skemë dublikohet edhe në kontratën koncesionare për ndërtimin e landfillit të inceneratorit në Fier. Të njëjtët persona, me të njëjtat kompani pa përvojë dhe, mbi të gjitha, pa kapacitete financiare, por me mbështetjen e pakursyer të zyrtarëve të lartë të qeverisë marrin përsipër ndërtimin e inceneratorit të Fierit me vlerë 3,7 miliardë të rinj pa TVSH.

Sërish kompania koncesionare Integrated Technology Waste Treatment Fier, e drejtuar në maxhorancë nga shtetasi Klodian Zoto, merr kredi financiare, e administruar si

provë, megjithëse në planin e biznesit kishte deklaruar se nuk do të merrte, duke vendosur si kolateral kontratën koncesionare.

E njëjta skemë sërish, ku kompania koncesionare, e cila kishte marrë përsipër ta kryente vetë investimin, nuk kryen pagesa nga buxheti i saj, por përdor shumat e parave që ka marrë si kredi dhe pagesat periodike nga buxheti i shtetit.

Po njësoj, një pjesë e parave që kompania i përfiton nga buxheti i shtetit, i ndan në formën e konsulencës dhe të nënkontraktimeve të shoqëri që janë pjesë e këtij rrjeti, si dhe të shoqëri fiktive, të cilat e ngarkojnë koncesionarin me fatura financiare fiktive.

Impiantit të incenerimit të mbetjeve në Fier ishte parashikuar t'i përfundonte ndërtimi në tetor të vitit 2019. Deri në mbylljen e punimeve të këtij komisioni hetimor, në mars të vitit 2022, impianti i përpunimit të mbetjeve në Fier rezultoi që nuk është në funksionim, ndërkohë që buxheti i shtetit rezulton se ka kryer 95% të pagesave të parashikuara në kontratën koncesionare. Në Tiranë skema ka një modifikim të vogël, megjithëse rezultati është i ngjashëm. Kontrata koncesionare parashikon të paguhet nga buxheti i ministrive, por përmes transfertës së pakushtëzuar prej bashkive të Tiranës dhe të Durrësit për momentin, me potencialin për t'u zgjeruar në të gjitha bashkitë e qarkut dhe më tej.

Kompania fituese e kontratës koncesionare, Integrated Energy BV, njëlloj si simotrat e saj në Elbasan dhe Fier, rezulton që të jetë pa eksperiencë në fushën e mbetjeve dhe pa mundësi financiare. Ajo përdor kontratën koncesionare si kolateral për të marrë kredi bankare, të cilën e përdor për fillimin e punimeve. Megjithëse kompania nuk i ka nisur punimet për ndërtimin e impianteve, por deri më sot ka rezultuar vetëm në kryerjen e punimeve paraprake për sistemimin e asaj që vazhdon të jetë ende landfill, kompania është duke i marrë të gjitha pagesat nga buxheti i shtetit. Në të tria raste nuk ka asnjë penalitet sipas kontratave.

Kompania koncesionare Integrated Energy BV, e regjistruar në Amsterdam të Holandës, kishte përfaqësues në kohën e nënshkrimit të kontratës shtetasin *Klodian Zoto*, i njëjti që shfaqet edhe në koncensionet e Fierit dhe të Elbasanit.

Ky komision, deputetët e opozitës në këtë komision, do t'i sigurojnë një skemë të lidhjes së tri kompanive organit të akuzës, për të kuptuar sesi ka funksionuar lidhja e qartë ndërmjet zotërimit të aksioneve nga një kompani tek tjetra.

Tarifa 29 euro për ton mbeturina, që është përcaktuar për shërbimin e plotë depozitim-incenerim të mbetjeve urbane, vazhdon të kryhet e plotë, ndërkohë që këto funksione nuk ushtrohen. Mirëpo, sipas përlllogaritjeve rezulton që kostoja reale që buxheti i shteti është duke paguar është 40,6 euro për ton. Impianti i incenerimit të mbetjeve në Tiranë nuk është ndërtuar dhe, siç rezultoi gjatë punimeve të komisionit hetimor parlamentar, ai pritet të ndërtohet në vitin 2025, me të paktën 36 deri 42 muaj vonesë nga firmosja e kontratës dhe

nga data kur ky impiant duhej të ishte dorëzuar. Ndërkohë, nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Bashkisë së Tiranës, paguhet e plotë tarifa prej 40,6 euro për ton mbeturina, pavarësisht se kompania koncesionare nuk e ofron shërbimin e incenerimit. Në total, kompania e incenerimit ka përfituar nga buxheti i shtetit vlerën e mbi 30 milionë eurove. Sakaq, qeveria qendrore dhe ajo lokale në bashkinë Tiranë, kanë ndikuar që kompania, e cila zotëron inceneratorin e Tiranës, të përfitojë një të ardhur ekstra në formën e një monopoli. Bashkia Tiranë ka detyruar të gjitha bizneset e ndërtimit të nënshkruajnë një kontratë me kompaninë në zotërim të inceneratorit të Tiranës. Të ardhurat që Integrated Energy BV përfiton nga ky monopol i legalizuar janë në vlerën e 48,9 milion euro, ashtu siç kompania ka deklaruar nga librat e shitjeve dhe të blerjeve.

Një tjetër e ardhur e përfituar nga kompania në pronësi të inceneratorit të Tiranës, është ajo nga bashkia e Durrësit. Përmes veprimeve të AKUM-it, nën drejtimin e Alqi Bllakos, u vendos mbyllja e vend-depozitimit të Porto Romanos pa u gjetur një zgjedhje alternative. Kështu, bashkia Durrës, nisi të negocionte një kontratë me inceneratorin e Tiranës, aq sa në fund përmes një tenderi publik me vlerë 10 milionë euro në formën, përsëri, të negociimit pa shpallje, i dorëzoi 10 milion euro kompanisë koncesionare të inceneratorit të Tiranës. Këto të ardhura kompania koncesionare e inceneratorit të Tiranës i shpërndan në tri kompanitë e sipërcituara, që zotërohen po nga i njëjti grup biznesesh, ITS dhe Zoto Consulting në pronësi të Klodian Zotos, si dhe SE Consulting në pronësi të Stela Gugalljas.

Një tjetër metodë sesi kompanitë i kanë përdorur paratë është edhe ajo e transferimit të kapitalit jashtë vendit. Ky proces nënkupton që një kompani të marrë shërbime nga kompani që janë të po kësaj kompanie gusckë, të regjistruara në vendet të njohura si parajsa fiskale, në rastin konkret në Holandë dhe në Maltë. Kjo është zakonisht një mënyrë që përdorin kompanitë që kanë bija në një vend, për të kryer transferime të kapitalit. Këto informacione kanë ardhur nga analiza e librave të shitjeve dhe të blerjeve. Kjo është kërkesa e katërt që i bëj organit të akuzës për të bërë një analizë të plotë se ku kanë shkuar këto kapital jashtë dhe sesi janë përdorur.

Në total, prej analizës së bërë nga ekspertët e Partisë Demokratike dhe nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, kompanitë koncesionare kanë deklaruar të paktën 94 fatura të tilla shërbimesh në librat e tyre të shitjeve dhe të blerjeve me një vlerë prej 25 milionë euro kapital i transferuar jashtë vendin, kapital që ne e kemi të deklaruar këtu në të 3 kompanitë Albtech Energy, Integrated Technology Waste Treatment Fier, Integrated Energy BVSP që fatkeqësisht është kapital i larguar nga Shqipëria.

Të tria këto kompani, pa kapacitet financiar, marrin në seri tri kontrata koncesionare, duke aplikuar sistemin që unë e shpjegova, sistemin e 3 kovave, duke përdorur kapitalin e marrë nga transfertat buxhetore për njërin prej inceneratorëve, duke përdorur për

inceneratorin e radhës dhe duke lëvizur me kapitalin e inceneratorit të dytë për ta përdorur atë në investimin e radhës në qytetin e Tiranës, të tretin. Asnjë lek, asnjë lek, asnjë qindarkë nuk është hedhur nga kompania si kapital privat. Është marrë një kredi bankare, por edhe sot edhe kësaj dite, për secilin prej inceneratorëve paguhet po me fondet e buxhetit të shtetit.

Kompanitë koncensionare kanë qarkulluar paratë e shtetit nga njëri projekt tek tjetri dhe në përfundim, siç rezultoi nga dokumentet nuk gjenden as në llogaritë bankare të këtyre kompanive. Të paktën për koncensionin dhe kontratën e impiantit të mbetjeve në Elbasan dhe në Tiranë, kompanitë koncensionare kishin detyrimin t'i kryenin punimet nga buxhetet e tyre financiare. Ndërkohë, asnjë prej tre impianteve nuk është funksional, siç rezultoi gjatë verifikimeve të kryera nga komisioni hetimor parlamentar.

Nga analizimi i të dhënave rezulton që kompanitë koncesionare të inceneratorëve kanë përdorur 3 mënyra për t'i qarkulluar paratë e buxhetit të shtetit duke krijuar një skemë të madhe piramidale dhe evazioni fiskal.

E para, kompanitë e inceneratorëve kanë përdorur buxhetin e shtetit për të tërhequr paradhënie shumicën e shumës së premtuar. Në formën e paradhënies më tej, ato kanë zhdoganuar mallra më pak sesa ajo që kanë pasur në kontratë, ku për secilin prej 3 inceneratorëve, të paktën në dy rastet ku impianti është blerë në rastin e Elbasanit dhe të Fierit, kontratat e zhdoganimeve janë në ½ ose 1/3 e vlerës që deklarohen në kontrata.

Së dyti, mënyra përmes së cilës ato kanë vepruar është ajo e krijimit të transfertave jashtë, 25 milionë euro nëpërmjet 3 kompanive, të cilët unë i përmenda, duke krijuar kështu mundësinë që paratë e buxhetit të shtetit të dalin jashtë territorit të Shqipërisë pa shkuar aty ku duhet të përfundonin këto 3 kontrata koncesionare.

Së treti, është detyra e krijimi të një miksi midis kompanive fiktive me fatura të TVSH-së dhe, gjithashtu, transferimi i parave te vetë kompania mëmë ITS, që zotërohet përsëri nga Klodian Zoto.

Unë kam këtu një përmbledhje të pagesave që Klodian Zoto ka marrë nga të 3 inceneratorët: kompania ITS 36 milionë euro, kompania Zoto Consulting 6 milionë euro, kompania SE Consulting, kompania e audimit e po të njëjtit grup 720 mijë euro. Ndërkohë, kam një listë të kompanive fiktive, të cilat kanë marrë pagesa nga të tria kompanitë e inceneratorëve. Nuk kemi siguruar dot të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për pagesat fiktive nga kompania "ITS", por nga të tria kontratat koncesionare unë kam këtu një shumë, që shkon mbi 15 milionë euro me kompanitë: "Froggy 03", "Leli 17", "RSIT&T", "AM CO&CO", "Pupa Services", "Froggy", "Leli 17" përsëri në Fier dhe në Elbasan, të ndryshme, "SG Logistic", "Xhevi Inert", "Best Services", "PIVOT 04", "SILI", "DETO", "Bellart Inert", "RB General", "TGVT", "J.P.Y" dhe "SH SH". Të gjitha kompanitë të sajuara, të krijuara enkas për të bërë xhirime faturash fiktive, ku një pjesë e tyre, 4 prej tyre, janë në

hetim njëkohësisht nga organi i akuzës për përfitimet që ka marrë ish-ministri i Mjedisit, Lefter Koka.

Për të njoftuar opinionin publik, kolegët deputetë në këtë komision, por edhe të gjithë ata qytetarë që janë të interesuar, nga viti 2016 deri në vitin 2018 një pjesë e këtyre kompanive, sipas këtij dokumenti të Prokurorisë së Tiranës, që ne kemi marrë në dorëzim si dëshmi, një pjesë e këtyre kompanive kanë qenë pjesë e një hetimi të ndodhur në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në Tiranë, por edhe pjesë e një vendimi, që është çuar në gjykatë, për të cilin ka një vendim për këto kompani. Qeveria shqiptare që në vitin 2016-2018 ka pasur dijeni për këtë skemë të pastrimit të parave dhe nuk ka marrë asnjë masë, absolutisht asnjë masë për ta parandaluar pastrimin e parave.

Sipas librave të shitjeve dhe të blerjeve, që janë analizuar nga deputetët dhe ekspertët e këtij komisioni, ka rezultuar se të tria koncesionet kanë pasur një vlerë të tyre reale vetëm 1/3, 2/3 kanë shkuar ose në drejtim të kompanive të Klodian Zotos, brenda Shqipërisë dhe jashtë Shqipërisë, ose nëpërmjet sistemit të faturave fiktive.

Për secilën prej këtyre kompanive ne kemi përgatitur një dosje me informacionin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, me pagesat e marra me faturat, me TVSH, pa TVSH, të cilat do t'ia vendosim në dispozicion edhe organit të akuzës.

Si ka nisur çdo gjë?! Çdo gjë ka nisur me një vendim të Komitetit Ndërmintor për Menaxhimin e Mbetjeve në fund të viti 2013, i cili konsiderohet si justifikimi kryesor për shpalljen e emergjencës. Ekspertët mjedisorë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kanë përgatitur një mendim prej rreth 10 faqesh sa i përket situatës mjedisore dhe marrjes së këtij vendimi, por ajo që ka rezultuar për këtë vendim është që ka ndodhur një koordinim perfekt i të gjitha strukturave të qeverisë për të shpallur gjendjen e emergjencës, duke e konsideruar gjendjen e emergjencës si baza ligjore, fillesë e gjithçkaje.

E dëgjuam nga anëtarët e këtij komisioni, e dëgjuam nga Kryeministri, e dëgjuam nga kryetari i Bashkisë së Elbasanit, por çfarë ka ndodhur realisht?!

Së pari, sipas ligjit, komisioni ose Komiteti Ndërmintor, që citohet për shpalljen e gjendjes së emergjencës kishte, në fakt, kishte vetëm funksion koordinimi dhe jo funksion vendimmarrës. Gjithsesi, kjo mungesë kompetence ligjore e komisionit nuk ka pse të jetë objekt i këtij hetimi parlamentar, duke qenë se në vetvete nuk ka asnjë akt ligjor për shpalljen e emergjencës. Vendimi që është marrë është nul, vendimi që është marrë nuk përmbush kushtet për shpalljen e emergjencës dhe e gjitha kjo sajese prej 430 milionë eurosh, që ka si fillim shpalljen e gjendjes së emergjencës në qytetin e Elbasanit, e ngritur, pikërisht, mbi këtë vendim, i cili nuk është vendim real, nuk është vendim, i cili bazon këto tri kontrata koncesionare, rrëzohet përtokë.

Unë nuk dua t'i hyjë fare në meritë diskutimit të këtij vendimi, sesi ishte kuorumi në momentin kur u mor ky vendim, që kishte tri veta që kishin firmosur, nuk dua t'i hyj fare faktit që ky vendim nuk kishte autoritet mbi kontratat koncesionare, mbi vendime parlamenti, mbi ligje, që një komitet ndërministror, me zëvendësministra, të ketë prioritet mbi ligjet e miratuara në këtë vend, por fakti qëndron që nuk ka absolutisht asnjë vendim për shpalljen e emergjencës dhe kjo, unë besoj, të nderuar kolegë, të nderuar qytetarë, është jashtëzakonisht e rëndë. Kryeministri i vendit ka gënjyer në këtë komision, deputetë të këtij komisioni kanë gënjyer për shpalljen e gjendjes së emergjencës, kanë thënë të pavërteta për shpalljen e gjendjes së emergjencës dhe tri kontrata koncesionare me vlerë 430 milionë euro janë dhënë me supozimin që ekziston gjendja e emergjencës, kur nuk ka asnjë shpallje ligjore të gjendjes së emergjencës.

E gjithë kjo skemë për shpalljen e gjendjes së emergjencës fiktive shtyu më vonë serinë e veprimeve të institucioneve lokale dhe qendrore për të ndërtuar këtë skemë korruptive. Ajo që konsiderohet si një aferë masive financiare është realizuar me mbështetjen e zyrtarëve të lartë shtetërorë dhe drejtues lokalë, të cilët renditen sipas rendit kronologjik, kështu siç unë po i lexoj, por jo sipas rëndësisë së akuzave.

Dua të informoj qytetarët dhe kolegët deputetë në këtë komision se të paktën 50 persona janë përfshirë në skemën masive të korrupsionit në aferën e inceneratorëve, 50 persona, të cilët kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë ligjore në vendimmarrjen e tyre, të cilët kanë firmosur dhe, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë shkaktuar demin financiar prej 430 milionë eurosh.

Unë dua të përmend këtu vetëm personat politikë me përgjegjësi ligjore.

Zoti Qazim Sejдини, kryetari i Bashkisë së Elbasanit, në kohën e procedurave për koncesionin e Elbasanit ka ndërmarrë hapat administrativë për shpalljen e gjendjes së emergjencës mjedisore në Elbasan, mbështetur në vendimin e Komitetit Ndërministror të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për shpalljen e fillimit të emergjencës, një vendim nul, i cili nuk ekziston dhe nuk duhet të kishte qenë si pikënisje për këto tri kontrata koncesionare.

Komiteti Ndërministror i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është organ këshillimor, nuk ka asnjë fuqi vendimmarrëse dhe nuk ka pasur kuorum, referuar ligjit për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe, për këtë arsye, procedura administrative, e nisur që në ditën e parë, që në momentin kur është nisur, nga kryetari i Bashkisë Elbasan, Qazim Sejдини, për shpalljen e emergjencës mjedisore është në kundërshtim me ligjin. Të gjitha procedurat që kanë vijuar nga ky moment, duke krijuar pasoja të rënda financiare për buxhetin e shtetit, janë në kundërshtim me ligjin.

Zoti Lefter Koka, ish-ministër i Mjedisit, ish- deputet i Partisë Socialiste, në periudhën 2013-2017, në kohën që janë nënshkruar kontratat koncesionare për Elbasanin,

Fierin dhe Tiranën, nga dokumentet e siguruara nga ky komisioni hetimor, por njëkohësisht edhe nga deklaratimet e dëshmitarëve, konsiderohet si një nga personat kyç për zhvillimin e procedurave në kundërshtim me ligjin, për dhënien e këtyre tri kontratave koncesionare, por, njëkohësisht, për zbatimin korruptiv të këtyre tri kontratave koncesionare dhe përfitimin direkt financiar nëpërmjet skemës së pastrimit të parave me 4 nga kompanitë që unë përmenda.

Zoti Arben Ahmetaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik dhe më tej ministër i Financave, gjatë kohës që janë zhvilluar procedurat për dhënien me koncesion të ndërtimit të impianteve të përpunimit të mbetjeve në Elbasan, Fier dhe në Tiranë.

Zoti Ahmetaj ka mbështetur procedurat për dhënien e koncesionit në Elbasan dhe në Fier, njëkohësisht, ka qenë zyrtari përgjegjës për të kontrolluar kontratat koncesionare, për zbatimin e pagesave të thesarit për këto tri kontrata, por, nga ana tjetër, në vitet 2016-2018 ka lejuar një skemë financiare pastrimi parash me dijeninë e tij. Tri drejtorë në drejtorinë e tatimeve kanë dhënë dorëheqjen, sepse nuk kanë pranuar t'i firmosin këto, ndërkohë që, me bekimin e zotit Ahmetaj, thesari i ka vazhduar pagesat që i vazhdon sot e kësaj dite.

Zoti Damian Gjijnuri ishte ministër i Infrastrukturës në kohën e dhënies së koncesioneve për ndërtimin e impianteve të përpunimit të mbetjeve në Elbasan, në Fier dhe në Tiranë. Zoti Gjijnuri ka mbështetur procedurat e paligjshme për ndërtimin e inceneratorit të Elbasanit, si dhe ka dështuar në mbikëqyrjen e punimeve të inceneratorit të Fierit dhe Tiranës; ka dështuar për të kontrolluar pagesat e inceneratorit të Fierit dhe Tiranës, duke lëshuar fatura financiare të pakontrolluara nga buxheti i shtetit.

Zoti Engjëll Agaçi, sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, i cili në këtë komision premtoi që do të sillte dokumente që, në fakt, ky komision i siguroi në mënyrë tjetër, tha të pavërteta në lidhje me procedurën për inceneratorin e Elbasanit. Ai ka luajtur një rol thelbësor në shkeljet e procedurave ligjore në rastin e miratimit të kontratës koncesionare për ndërtimin e landfillit dhe inceneratorit të Elbasanit. Ai është përgjegjës për tolerimin dhe përfshirjen e një projektvendimi për financimin e një kontrate, e cila ishte firmosur pas një procedure të pabazuar në ligj.

Zoti Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë, në cilësinë e kreut të qeverisë, është përgjegjës i drejtpërdrejtë për shkeljen e procedurave nga ana e vartësve të tij, ministrave, në procedurat e dhënies me koncesion të të tri kontratave në Elbasan, Fier dhe Tiranë.

Zoti Armando Subashi, kryetar i Bashkisë së Fierit, është përgjegjësi kryesor për koston që i është shkaktuar buxhetit të shtetit për moszbatimin e kontratës së inceneratorit të Fierit, njëkohësisht me kosto financiare edhe për sa i përket çështjes së pronës në qytetin e Fierit.

Zoti Alqi Bllako ishte sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit në kohën e procedurave për dhënien me koncesion të ndërtimit të impianteve në Fier dhe Tiranë. Zoti Bllako është përgjegjës për ndjekjen e procedurave në kundërshtim me ligjin, si dhe për lejimin e aferës financiare që lidhet me inceneratorin e Fierit dhe atë të Elbasanit.

Zoti Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë së Tiranës, është përgjegjës për shmangien e këshillit bashkiak dhe miratimin për dhënien me koncesion për ndërtimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve në Sharrë, Tiranë, në tejkalim flagrant të kompetencave të tij. Zoti Veliaj vazhdon të paguajë tarifën 40,6 euro/ton për shërbimin e depozitimit dhe incenerimit të mbetjeve në Tiranë, ndërkohë që procesi i incenerimit nuk është kryer për mungesë të impiantit, duke i shkaktuar në këtë mënyrë një dëm kolosal buxhetit të shtetit. Zoti Veliaj i ka siguruar një monopol kompanisë koncesionare përmes një tarife të pamiruar nga këshilli bashkiak, në kundërshtim të plotë me ligjin për pushtetin vendor dhe ligjin për menaxhimin e financave vendore.

Zonja Emirjana Sako, fatkeqësisht kryetare e Bashkisë së Durrësit, përmes akteve të saj ka kryer një procedurë të dyshimtë të dhënies me tender publik të formës “Negocim pa shpallje” me vlerë fillestare të shpallur prej 2 milionë eurosh dhe më pas të shndërruar në një tender publik me vlerë 10 milionë euro. Ky tender publik u publikua në formatin e negociimit pa shpallje, duke favorizuar kompaninë e inceneratorit të Tiranës në një prokurim publik në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike.

Lista e zyrtarëve shtetërorë, që janë të përfshirë në këtë aferë korruptive, është të paktën 50, duke përfshirë disa nga sekretarët e Përgjithshëm të ministrive përgjegjëse për zbatimin e këtyre kontratave, komisionet e koncesionit, komisionet e dhënies me koncesion dhe hartimit të këtyre kontratave koncensionare, njëkohësisht, njësitë e zbatimit të projektit. Gjatë zbatimit të këtij projekti janë vënë re shkelje të rënda me dëm financiar, por, njëkohësisht, edhe në shëndetin e qytetarëve, për të cilët nuk janë marrë masa.

Në inceneratorin e Elbasanit ka një problem të jashtëzakonshëm për sa u përket hireve dhe nuk ka një depozitim special, një vend special për to. Në inceneratorin e Tiranës ndërkohë që flasim janë duke u bërë ndërtime për mbetje të rrezikshme, jo radioaktive, për të cilat nuk ka asnjë masë dhe asnjë penalitet. Këto kontrata koncensionare, përveç dëmit prej 430 milionë eurosh, janë duke shkaktuar edhe një dëm të jashtëzakonshëm mjedisor, por, njëkohësisht, edhe në jetën e qytetarëve shqiptarë.

Përfituesit e këtyre tri kontratave koncensionare në Elbasan Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “*Albtech Energy*” kanë nënshkruar kontratën, bazuar në vendimin nr. 907 të Këshillit të Ministrave me një kosto koncensionare 3 miliardë lekë pa TVSH dëm për buxhetin e shtetit. Procedura e ndjekur ishte “Negocim pa shpallje” dhe afati i koncesionit ishte 7 vjet.

Kompania “*Albtech Energy*”, e regjistruar në datën 10.07.2014, zotërohet nga Stela Gugallja, ku kjo kompani ka prezantuar një projekt paraprak vetëm me 4 faqe, të hartuar nga shoqëria “*Integrated Technology Service*”, në pronësi 100% të Klodian Zotos. Në kërkesën për shprehje interesi për koncesion kompania ka një kapital themeltar 100 000 lekë dhe angazhohet për një investim 22 milionë euro dhe do të përballonte deri 120-140 tonë mbetje në ditë. Kjo nuk ndodh.

Në datën 27.10.2014 shoqëria “*Albtech Energy*” i paraqet Ministrisë së Mjedisit studimin e përgatitur nga Ernesto Granelli, pronar i kompanisë “*Energy Recuperator*”

Zonja Stela Gugallja dhe Ernesto Granelli, si përfaqësues i “*Energy Recuperator*”, njëkohësisht, edhe nga zoti Mirel Mërtiri që zotëron kompaninë “*ER One*”

Shoqëria “*Albtech Energy sh.p.k*” ka lidhur kontrata nënkontraktimi po me të njëjtit pronar “*SE Partners*”, e cila zotërohet nga zonja Stela Gugallja, që është themeluar në tetor të vitit 2017 dhe, fatkeqësisht, kryen auditimin e të gjitha këtyre kompanive dhe nga zoti Erton Kaleshi, i cili është larguar nga kompania në datën 30 janar për të filluar punë si këshilltar i ministrit të Financave.

Kompanitë “*Zoto Consulting*” dhe “*Integrated Technology Service*” janë kompani në pronësi të shtetasit Klodian Zoto dhe janë themeluar në vitet, respektivisht 14.09.2017 dhe 02.11.2020, të njëjtë emra si dhe në koncesionin e Fierit dhe të Tiranës, janë pothuajse të njëjtat kompani.

Në Fier po i njëjti grup njerëzish bën një ofertë të pakërkuar dhe qeveria shqiptare ndjek një procedurë të hapur për afatin e koncesionit 6 vjet, që duhet të kishte përfunduar dhe sot nuk ka përfunduar, me një vlerë kontrate 3,7 miliardë pa TVSH.

Emrat Klodian Zoto dhe Ernesto Granelli, që ishin shfaqur më parë në kontratën e Elbasanit, rishfaqen edhe një herë në kontratën e Fierit. Para nënshkrimit të kontratës koncensionare ka pasur ndryshime të pronësisë së kompanive, të cilat janë administruar si prova në këtë komision dhe duhet të jenë pjesë e objektit të hetimit të organit të akuzës.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 341 të vitit 2016, kjo kompani ka marr një bonus prej 10% të pikëve për elemente, të cilat nuk i meritonte dhe nuk u takonte që t'i merrnin.

Kompania “*Building Construction and Green Energy*”, e cila ishte themeluar në vitin 2015 në pronësi të tri ortakëve, është përsëri kompani që shfaqet në inceneratorin e Fierit. Këto kompani në këtë mënyrë zotërojnë 50% të të gjitha kompanive, që zotërohen nga shtetasi Klodian Zoto dhe rezultojnë përfituesit edhe në rastin e inceneratorit të Fierit.

Në datën 08.08.2016 kompania e shtetasit Klodian Zoto i shet 100% të kuotave shtetasit Loran Dushaj, që ishte shtetasi që administronte inceneratorin e Fierit. Në datën 18 korrik publikohet shpallja e kontratës për hapjen e garës, por, faktikisht, nuk ka garë,

kompania, që kishte paraqitur ofertën e pakërkuar dhe që merr bonusin, nuk paraqitet në garë. Më 15.09.2016 Ministria e Mjedisit kualifikon si fituese të koncesionit “*Integrated Technology Services & Energy 2SRL*”, e cila i shet menjëherë aksionet të “Montim- Ndërtimi, Patos”.

Në rastin e Tiranës në datën 28.08.2017 Ministria e Mjedisit njoftoi se shoqëria “*Integrated Energy BV*” me seli në Holandë ishte fituese e procedurës së dhënies me koncesion për një kontratë zbatimi 30-vjeçare. Vlera e koncesionit ishte 128,3 milionë euro pa TVSH. Në procedurat paraprake, para shpalljes, shfaqen po të njëjtët fitues, po të njëjtat kompani, për të cilat ne kemi përgatitur një skemë që do t’i dorëzohet organit të akuzës, të cilët marrin në pronësi edhe këtë kontratë koncesionare.

Të nderuar qytetarë, që keni ndjekur ditë pas dite punën e këtij komisioni hetimor, mbledhjen e provave, dëshmitë, diskutimet, debatet parlamentare, që më keni shkruar personalisht, por edhe anëtarëve të këtij komisioni mesazhe pa fund me problemet e zbatimit të këtyre kontratave, të aferës korruptive, të çështjes së shpronësimeve, sidomos në qytetin e Tiranës, unë besoj se kontributi, informacioni juaj na ka ndihmuar të gjithëve për të arritur në një raport voluminoz prej 120 faqesh që ia paraqesim Kuvendit të Shqipërisë për të zbardhur të plotë aferën korruptive më kriminale që kemi lexuar, kemi dokumentuar e kemi parë në këta 30 vjet: afera e 430 milionë eurove nga një grup njerëzish, pa asnjë eksperiencë, pa asnjë kapital që, në bashkëpunim me pushtetarë dhe me lidhje të forta korruptive, sot janë kthyer në përfituesit më të mëdhenj të buxhetit të shtetit. Një aferë e këtyre përmasave nuk mund të ndodhte, nëse nuk do të ishin përfshirë nivelet më të larta politike: Kryeministri Edi Rama; ministrat Arben Ahmetaj, Gjiknuri, Koka; sekretarët e Përgjithshëm, Agaçi dhe Billako; kryebashkiakët, Veliaj, Sejdiu dhe Subashi dhe një zinxhir zyrtarësh prej 50 personash publikë që me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë lejuar vjedhjen galopante të parave të shqiptarëve.

Ndaj, në përfundim të këtij parashtrimi të shkurtër prej 12 faqesh, që është vetëm një përmbledhje e punës së deputetëve të opozitës në këtë komision, unë sot kam një thirrje të fortë dhe të qartë për të gjithë prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar: tani është në dorën tuaj, merreni këtë raport, lexojeni me vëmendje, zbardhini ato pjesë që ky komision është penguar për të hetuar, të cilat i përmenda pak më lart, dhe dërgoni përpara drejtësisë të gjithë zinxhirin e gjatë të funksionarëve publikë të përfshirë në këtë grup të strukturuar kriminal!

Sytë e qytetarëve, e shqiptarëve janë të gjithë sot drejt organeve të reja të drejtësisë. Sytë e familjeve, sytë e fëmijëve shqiptarë, sytë e kujtdo, që sot i mungon shpresa, janë drejtuar drejt organeve të drejtësisë. Prandaj, kam një kërkesë në emër të Partisë Demokratike: mos na zhgënjëni! Mos i zhgënjëni shqiptarët! Para këtyre fakteve që ulërijnë

fort, para këtyre provave që ulërijnë fort, para dëshmimeve që të gjithë dëgjuam këtu në këtë komision, por që të gjithë qytetarët shqiptarë i panë, mos na zhgënjëni ne! Mos zhgënjëni fëmijët tuaj! Mos zhgënjëni qytetarët shqiptarë! Sot drejtësia ka në dorë ta zbardhë këtë aferë. Mosveprimi i tyre do t'i bëjë ata pjesë të kësaj afere kriminale.

Faleminderit!

Pas këtij parashtrimi të shkurtër, ia jap fjalën zonjës Ermonela Felaj, zëvendëskryetare e komisionit, për të prezantuar pjesën e raportit në lidhje me gjetjet e maxhorancës.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Më lejoni dhe mua t'i bashkohem urimit tuaj, në emër të anëtarëve përfaqësues të maxhorancës në këtë komision hetimor, lidhur me festën e mësuesit. Është një ditë, e cila meriton të respektohet dhe të nderohet, gjithmonë për atë kujtimin e mirë që ne sot, në moshë të rritur, ruajmë për të gjithë mësuesit tanë, për të gjitha ata formësuar shumëçka nga ajo që jemi sot. Meqenëse dita e 7 Marsit përkon edhe me shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve, dua të uroj edhe fituesit e këtyre zgjedhjeve nga 6 në 5 bashki të vendit, përfaqësues të PS-së, që ata të jenë në lartësinë e përbushjes së sfidës së mirëqeverisjes së bashkive, në të cilat u zgjodhën të drejtojnë.

Falënderimin tjetër e kam për anëtarët e këtij komisioni, kolegët e mi të maxhorancës, për të gjithë durimin, për orët e zgjatura të debatit dhe diskutimit në këtë komision parlamentar, por edhe më shpesh për durimin e treguar ndaj sjelljeve cinike, të cilat kanë synuar të vinin në pah, ose t'i bënin me dije publikut që në PS ka njerëz pa integritet. Në fakt, nuk është fare kështu, sepse Partia Socialiste pikërisht, në sajë të njerëzve që e mbështesin dhe njerëzve që çojnë përpara punët e këtij vendi, ka marrë dhe do të vijojë të marrë mbështetjen e merituar.

Të kthehem i raporti i komisionit hetimor parlamentar. Neni 22 i ligjit “Për komisionet hetimore” na orienton që në mbledhjen e sotme do të duhet që ne të miratojmë me vendim përfundimtar raportin e komisionit hetimor parlamentar. Sigurisht që qëndrimet ishin paralajmëruar që më herët se do të ishin të ndryshme nga ana e anëtarëve të këtij komisioni dhe, për këtë arsye, përfaqësuesit e maxhorancës vijnë me një raport në këtë komision parlamentar, një raport, i cili edhe për nga përmbajtja, edhe për nga analiza që synon t'u bëjë ligjit dhe vendimeve të ndryshme të Këshillit të Ministrave, apo le t'i quajmë tërësisë së akteve nënligjore në lidhje me procedurat e ndërtimit dhe vënies në funksionim të impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane, mbetet një raport kompleks.

Sidoqoftë, në vijim të shembullit që dha opozita për t'iu referuar sot publikut me një raport të përmbledhur, edhe unë do të mundohem të bëj një përmbledhje të këtij raporti, të cilin dua të nënvizoj që ne e kemi gati për mbledhjen e sotme. Prandaj nuk do të ndryshonte asgjë, edhe sikur të lexonim të gjitha faqet e këtij raporti. Raporti do të ketë rast të lexohet

edhe nga ana jonë, edhe nga ana e opozitës për arsyen e thjeshtë, sepse raportet i përcillen Kuvendit të Shqipërisë dhe në seancën plenare ato i nënshtrohen edhe një herë prezantimit dhe votimit nga ana e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

Komisioni hetimor, mbi bazën e të cilit ne kemi vepruar që nga fundi i tetorit të vitit 2021, është ngritur me vendimin nr. 81 të Kuvendit të Shqipërisë, sipas kërkesës së opozitës.

Objekti i këtij komisioni hetimor është ai që lidhet me kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane.

Dua të rikthehem edhe një herë te vendimi, sepse është shumë i rëndësishëm, për të kuptuar se çfarë detyrash kishte ky komision dhe cila do të ishte qasja e këtij komisioni në raport me këto detyra.

Hetimi synonte nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, garantimin e transparencës, mbrojtjen e konkurrencës dhe tregut të lirë dhe garantimin e të drejtës së qytetarëve për një mjedis më të pastër në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Sipas këtij vendimi, komisioni hetimor duhet të bënte transparencë të plotë për çdo çështje të përfshirë në objektin e veprimtarisë së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Në funksion të këtij objekti hetimor dhe detyrave që ne patëm, sigurisht që ndërtuam planin paraprak të hetimit, mandej e kompletuam këtë plan duke miratuar planin e hetimeve të komisionit hetimor, një plan i cili, realisht, është mbështetur në tri shtylla kryesore: në mbledhjen e të dhënave nga institucionet zyrtare ose institucionet shtetërore, dhe jo vetëm; në konstatimin e vendeve, në të cilat ngrihen sot dhe funksionojnë impiantet e trajtimit të mbetjeve në Fier, Elbasan dhe Tiranë, natyrisht, edhe në pyetjen e dëshmitarëve, një pyetje e cila u realizua në masë të plotë, duke përjashtuar këtu vetëm dëshmitarët e kërkuar, të cilët ndërkohë janë bërë pjesë e hetimeve të Prokurorisë së Posaçme.

Sidoqoftë, le të kujtojmë edhe një herë se cilat ishin të dhënat për situatën mjedisore në Shqipëri. Deri në vitin 2013 situata e menaxhimit të mbetjeve urbane në vendin tonë ishte katastrofike. Në vitin 2013 mjedisi, për më tepër menaxhimi i mbetjeve nuk konsiderohej nga askush as si prioritet dhe as si një urë lidhëse për zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit.

Si të ecim me hapa të shpejtë për të qenë në një linjë me vendet europiane sa i takon menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe promovimit të ekonomisë qarkulluese?! Shumë shpejt dhe për të kujtuar edhe një herë që përpara vitit 2013 panorama e menaxhimit të mbetjeve ishte në nivele shumë të dobëta. Kjo dukej qartësisht, pasi u trashëguan venddepozitime nga ish-komunat, të cilat në pjesën më të madhe ishin ndërtuar në brigjet

lumore apo në vende, të cilat dëlnin jashtë çdo standardi mjedisor, duke ndotur lumenjtë dhe detet.

Nuk ka pasur asnjë lloj metodologjie të qartë, të unifikuar për të përcaktuar, në fakt, se sa kushton menaxhimi i mbetjeve. Lejohej importi i një liste mbetjesh, por duhet thënë që sistemi i kontrollit nuk ka qenë në nivelin që duhej dhe sigurisht që kjo ka lënë hapësira edhe për hyrjen e mbetjeve të rrezikshme në vend. Shërbimi i pastrimit ishte shumë i kufizuar, koshat ndodheshin vetëm në pjesë të caktuara të zonave urbane, kishte pamjaftueshmëri financiare që reflektohej, gjithashtu, edhe në mungesën e plotë të infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve.

Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve filloi në kushtet e këtij konteksti, kur venddepozitimet ekzistuese kishin mbaruar *de jure* dhe *de facto* funksionalitetin e tyre, moment ky që në vetvete përcaktoi edhe shpalljen e emergjencës mjedisore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky fakt, pavarësisht interpretimeve që i bëhen vendimit të Komitetit Ndërmintor për Integrimin dhe Menaxhimin e Mbetjeve nuk mund të lihet jashtë vëmendjes së këtij komisioni dhe jashtë vëmendjes së publikut, pasi në komisionin hetimor parlamentar u analizua në mënyrë të hollësishme ky fakt, si nëpërmjet përmbajtjes së vendimeve të këshillave bashkiakë të bashkive Elbasan, Fier, Durrës, meqenëse u trajtua edhe rasti i Durrësit, vendime të cilat, në fakt, janë marrë me unanimitet të këshilltarëve, të majtë dhe të djathtë.

Ishin këto vendime që kanë pasur vendimmarrjen e Komiteti Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve për emergjencën mjedisore. Ne, po ashtu, administruam në këtë komision hetimor parlamentar edhe shumë të dhëna dokumentare të bashkive për sa i takon gjendjes apo kontekstit, në të cilin përshkruhej situata mjedisore deri në vitin 2013; kemi marrë, po ashtu, dëshmitë e kryetarëve të pushtetit lokal dhe, natyrisht, kemi edhe një informacion të plotë shkresor që na e ka vënë në dispozicion Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.

Ish-fushat e mbetjeve në bashkitë Elbasan, Fier dhe Tiranë kishin dalë jashtë funksionimit të tyre, që të jeni të qartë, si fusha të ngritura që 25 vjet më parë. Sharra është një fushë e ngritur 25 vjet më parë, dhe këtu marr për referencë vitin 2015, kur ajo mbaronte funksionin e saj apo të tjera, si Fieri dhe Elbasani që ishin ngritur që në kohën e regjimit komunist, në vitet '70. Mjafton në vetvete nënvizimi i afatit kohor të lartpërmendur për secilin nga këto impiante për ta kuptuar qartësisht alertin mjedisor përballë të cilit gjendeshin në vitet që po flasim e që me të drejtë është përshkruar në dokumente të ndryshme zyrtare, por edhe në pamje filmike dhe fotografike, të marra këto edhe nga burime të pavarura, të administruara rregullisht në komision, si një katastrofë e vërtetë mjedisore, veçanërisht në

bashkitë në fjalë, për të cilat ndërkohë dihej botërisht se edhe e kaluara e tyre industriale, e kam fjalën për Elbasanin dhe Fierin, në kohën e regjimit komunist ishte një arsye themelore për situatën tejet të rënduar mjedisore, sidomos në periudhën posttransitore të qeverisjes së vendit, kur vendi dihet se ndryshoi sistemin politik të qeverisjes, duke kaluar në një demokraci parlamentare.

Hetimi parlamentar lidhur me procedurat e ndërtimit dhe vënien në funksion të impianteve të trajtimit të mbetjeve, për sa na takon ne, përfaqësuesve të maxhorancës, duhej të ngelej i ndarë nga hetimi penal, i cili po zhvillohet nga strukturat e SPAK-ut, kjo në respekt të Kushtetutës, të nenit 7 të saj, ku sanksionohet si vijon: “Sistemi qeverisës në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve, ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”.

E vërteta, në fakt, është se ky parim u shkel që në krye të herës nga kërkuesit e këtij komisioni, të cilët që në nisje të këtij komisioni në çdo qëndrim verbal dhe në çdo dokument parlamentar të paraqitur nga ana e tyre ngritën akuza penale, shpallën akuza penale, shpallën fajtorë, kërkuan të ushtrojnë ndikim tek organi i ndjekjes penale, të cilit ligji themeltar i Republikës së Shqipërisë, pra Kushtetuta, në nenin 148, paragrafi i parë dhe i dytë, i jep ekskluzivitetin e ngritjes së akuzës dhe pavarësinë në ushtrimin e funksioneve.

Po ua lexoj neni 148 të Kushtetutës: “Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në këtë ligj. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit”.

Mosrespektimi sa më lart, çoi në shkelje të rëndësishme përmbajtjesore dhe procedurale nga ana e komisionit hetimor parlamentar, të reflektuara hapur në drejtimin dhe zhvillimin e mbledhjeve në kërkesa për mbledhje informacioni, në mënyrën e pyetjes së dëshmitarëve dhe në përfundimet e kërkuesve, që sapo dëgjuam.

Qëllimi i çdo hetimi parlamentar është të hetojë sjelljen e subjekteve publike në raport me ligjin dhe detyrën, duke u kujdesur të identifikojë mangësi të ligjit, vakuume të parashikimeve të duhura ligjore, për të cilat Kuvendi, si përfaqësues dhe mbajtës i pushtetit legjislativ ka për detyrë të përmirësojë, ka për detyrë të orientojë, të detyrojë, të sanksionojë, gjithmonë përmes instrumentit ligjor, sjelljen e përshtatshme, rregullimin e duhur të fushave të ndryshme të veprimtarisë shoqërore, marrëdhënieve socio-ekonomike dhe politike.

Po ashtu, është detyrë e Kuvendit, që në një rast eventual, që jo domosdoshmërisht ka lidhje me këtë hetim, të paraqesë edhe mjetet e kufizimit të bartësve të pushtetit ekzekutiv. Sjellja e subjekteve private, qofshin këta persona fizikë apo juridikë, në raport me ligjin, nuk mund dhe nuk duhet të jetë objekt i këtij hetimi parlamentar në kuptimin e ngritjes së akuzave

penale, sepse kjo nuk është në tagrin e parlamentit dhe sigurisht nuk është as në interesin publik të veprimtarisë që ushtron parlamenti.

Sidoqoftë, në këtë raport, pavarësisht qasjes së kemi sa i takon mënyrës se si do të funksiononte ky hetim parlamentar, në respekt të detyrës që na u dha për të mbledhur fakte dhe të dhëna, gjithmonë në lidhje me një çështje që konsiderohet e rëndësishme për interesin publik, pra çështja e trajtimit të mjedisit, ne do të përcjellim konkluzionet tona për gjithë situatën faktike në të cilën u operua me ndërtimin dhe vënien në funksionim të impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane në Elbasan, në Fier, në Tiranë, duke analizuar veçmas secilën prej këtyre praktikave koncesionare.

Po marr praktikën koncesionare të Elbasanit dhe po kufizohem vetëm në të dhënat kryesore të kontratës.

Të dhënat kryesore të kontratës:

Autoritet kontraktues-Ministria e Mjedisit. Koncesionar ka qenë Albtec Energy sh. p. k.

Forma e koncesionit është ajo që njihet si botë ose ndërtim-operim-transferim.

Data e lidhjes së kontratës është data 16 dhjetor 2014. Periudha e parashikuar e koncesionit 7 vjet.

Vlera e kontratës 21 milionë e 600 mijë euro.

Vendndodhja: në juglindje të ish-Kombinatit Metalurgjik Elbasan, në vendin e hedhjes së mbeturinave të këtij kombinati, 33 kilometra nga Tirana.

Të gjitha këto të dhëna janë konform të dhënave që figurojnë në kontratën koncesionare të Elbasanit, që unë thjesht i citova.

Autoriteti Kontraktor, në të tre rastet e kontratave koncesionare, pra Elbasani, Fieri dhe Tirana, ka qenë ministri i Mjedisit. Kjo sipas ligjit 10 463, datë 22. 9. 20011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili në përkufizim të termave të përdorur, dhe po i referohem nenit 3 të ligjit, për shembull, parashikon se termat “ministër” dhe “ministri”, i referohen përkatësisht ministrit përgjegjës për Mjedisin dhe Ministrisë përgjegjëse për Mjedisin.

Më tej akoma: neni 65 i të njëjtit ligj parashikon: “Nxitja e investimeve private dhe e partneritetit publik privat. Këshilli i Ministrave nxit angazhimin e sektorit privat dhe partneritetin publik privat në veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, një ligj që e kemi pasur që prej vitit 2011.

Projektet që, në gjykimin e ministrisë synojnë të realizojnë masat e planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, jepen në koncesion, në përputhje me ligjin 9663 të vitit 2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar. E theksoj shumë kohën e daljes së ligjeve edhe për të kuptuar që nuk është se është ndryshuar kuadri ligjor për të bërë impiantet e trajtimit të

mbetjeve, por është vepruar mbi një kuadër ligjor, të cilin e ka përdorur edhe një qeverisje para nesh.

Gjithashtu, në VKM-në për fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit, VKM-ja numër 945 e vitit 2013, përcaktohet qartë se Ministria e Mjedisit harton dhe zbaton politika, të cilat synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, nxitjen dhe promovimin e burimeve të rinovueshme, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, të pyjeve, të kullotave, mbrojtjen e cilësisë së ujërave dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Më tej akoma, thuhet se Ministria e Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës.

Pra, sipas ligjit dhe VKM-së që sapo citova, Ministri i Mjedisit kishte dhe ka ende sot përgjegjësinë që të angazhohet në çështjet e mjedisit. Sigurisht, te kjo pjesë e praktikës koncesionare të Elbasanit ne do t'i përmbahemi të njëjtit qëndrim, që kemi referuar edhe gjatë kohës së zhvillimit të punës në këtë komision hetimor, në kuptimin që ne nuk do të komentojmë ndonjë veprim të autoritetit kontraktor, Ministrisë së Mjedisit në këtë procedurë, për faktin se kjo është një procedurë që po hetohet nga drejtësia, ngaqë sigurisht që ne kemi respekt për punën dhe përfundimet në të cilat do të arrijë jo vetëm prokuroria, por edhe gjykata, dhe është e rëndësishme ta theksojmë këtë.

Ndërkohë, ne nuk bëjmë avokatinë e askujt. E para, sepse nuk kemi nevojë ta bëjmë këtë lloj gjëje; e dyta, sepse jemi shumë të qartë, gjithmonë në bazë të ligjit, për diferencën mes asaj që është përgjegjësi individuale, e ndryshme nga përgjegjësia kolektive, e cila kurrë dhe asnjëherë nuk mund të jetë penale. Përgjegjësia penale është individuale, dhe këtë legjislacioni penal e shpreh saktësisht në disa nene të tij:

Neni 1: “Ligji penal dhe ndarja e veprave penale”

Neni 2: “Mosdënimi pa ligj”

Neni 3: “Veprimi në kohë i ligjit penal”.

Nenet 6, 7, 8, 9, 10, 11 “Për zbatimin e ligjit penal”.

Neni 12: “Mosha për përgjegjësi penale”.

Pra, të gjitha këto nene të Kodit Penal do të duhej të ishin kuptuar drejt, gjë që nuk vlen vetëm për dikë që ka formimin e juristit, por mbi të gjitha duhet të vlejë për një ligjvënës, që presupozohet të ketë ose të fitojë një kulturë minimale juridike, në bazë të së cilës të qëndrojë respekti, përpjekja dhe detyrimi për ta lexuar dhe kuptuar siç duhet ligjin, dhe po flasim për ligjet kryesore që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.

Institucionet gjithashtu, presupozohet të sillen në bazë të ligjit, dhe nëse kjo nuk rezulton e tillë, na takon ne ligjvënësve që të identifikojmë dhe të marrim masa për ta korrigjuar situatën. Në rastin konkret, ne kemi shqyrtuar me vëmendje sjelljen e

institucioneve publike dhe kemi konstatuar se këshilli bashkiak, bashkia Elbasan, prefekti i qarkut Elbasan, kanë qenë realisht të shqetësuar në lidhje me situatën mjedisore në qarkun e tyre, dhe në këtë komision hetimor nuk u arrit të sillej as edhe një provë, as edhe një e dhënë, qoftë dhe indirekte, që të tregonte apo të provonte të kundërtën në raport me të gjitha ato që unë përmenda.

Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, por edhe ligji “Për trajtimin e mbetjeve” i japin përgjegjësi të plotë edhe pushtetit lokal për t’u angazhuar e për t’u dhënë shërbim qytetarëve, sa i takon pastrimit dhe trajtimit të mbetjeve.

Le të vijmë në një moment tjetër. Në lidhje me procedurën koncesionare të Elbasanit, gjithmonë nga ana e kërkuesve të këtij komisioni hetimor është pretenduar që ky koncesion ose impiant i incenerimit nuk funksionon. Pra, po flasim për një impiant të veçantë, meqenëse impiantet e trajtimit janë më komplekse për sa i takon mënyrës së ndërtimit dhe projektimit të tyre.

Ne në komisionin hetimor kemi administruar një shkresë, dhe është shumë e rëndësishme të themi që përmbajtja e kësaj shkrese nuk është arritur të kontestohet me prova të tjera, që është shkresa e OSHEE-së, datë 23.11.2021, me numër protokoll nr. 12258/2, në të cilën konfirmohet se për inceneratorin në Elbasan ju bëj me dije se shoqëria “Albtek Energy” ka aplikuar pranë OSHEE-së për lidhje të burimit gjenerues me rrjetin shpërndarës të OSHEE-së që në gusht të vitit 2016. Në prill të vitit 2017 është instaluar në objekt matësi i energjisë me 2 drejtime. Në datën 06.06.2017 shoqëria ka njoftuar OSHEE-në se do të kalojë në regjim dhënie energjie në rrjetin e operatorit të shpërndarjes. Deri në datën 8 nëntor 2021 rezulton se ky subjekt ka injektuar në rrjetin shpërndarës të energjisë sasinë e energjisë prej 6748, 2 megavatsh dhe ka përdorur për nevojat e veta sasinë e energjisë prej 2792,6 megavatësh.

Me këtë të dhënë shkresore, si dhe me konstatimin në vend nga ana e komisionit hetimor sa i takon vendosjes së matësit dhe kabinës elektrike bie poshtë pretendimi se në Elbasan nuk është bërë asnjëherë incenerim gjatë kohës së operimit të kontratës koncesionare, një kontratë që u lidh nga ministri i Mjedisit, në bazë të përgjegjësisë së qartë, që thamë, që ia ngarkon ligji “Për trajtimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Vendimmarrja mandej e autoriteteve të tjera shtetërore, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave, ka qenë një vendimmarrje e ardhur si rezultat i zhvillimit të një procesi të iniciuar nga organi përgjegjës dhe që ka finalizuar, sikundër u konfirmua sërish edhe kjo nga konstatimi në vend i impiantit të Elbasanit, në zgjidhjen e problemit të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve për 5 nga 7 bashkitë e qarkut të Elbasanit: si Bashkia Elbasan, Bashkia Cërrik, Bashkia Belsh, Bashkia Librazhd dhe Bashkia Gramsh, përveç Përrenjasit dhe Peqinit, që nuk janë ende gati për t’i çuar mbetje te ky impiant për një sasi ditore, sot që

flasim, 100 deri në 104 tonë në ditë, mbetje të cilat ne i verifikuam edhe në vend, i nënshtrohen peshimit, seleksionimit, kompostimit, incenerimit deri në momentin që ky objekt u sekuestrua me 0 kosto për shërbim.

Impianti i ngritur në Elbasan nuk i ka shërbyer dhe nuk i shërben thjesht funksionit të mbledhjes dhe trajtimit të mbetjeve, por sot që flasim janë eliminuar pasojat e rënda të ish-dampës së hireve në Elbasan, sepse kjo sipërfaqe, ku sot zhvillon aktivitetin impianti, është tërësisht e rehabilituar dhe po kështu renë toksike, për të cilën jemi dëshmitarë të gjithë që ekzistonte në Elbasan, nuk e shohim më.

Hetimi parlamentar për Elbasanin rezultoi në përfundime, të cilat tregojnë qartësisht se opozita nuk kishte dhe nuk ka asnjë qasje me provueshmërinë e akuzave për grup të strukturuar kriminal, për korrupsion të kryer në bashkëpunim me qeverinë, zyrtarëve lokalë, për pastrim të produkteve të veprës penale. Asgjë e tillë nuk u provua dhe nuk provohet se ekziston përballë fakteve dhe të dhënave të qarta e të plota, që u analizuan në debatin parlamentar, por edhe gjatë marrjes së dëshmimeve. Çdo abuzim me ligjin, që dyshohet të kenë kryer palët kontraktuese të kontratës koncesionare, nuk është në tagrin e komisionit hetimor parlamentar për ta gjykuar dhe konfirmuar si të vërtetë, sikundër nuk mundet që kjo e dhënë të shndërrohet në një akuzë kolektive për Këshillin e Ministrave, për Kryeministrin, pasi qartësisht dhe në analizë të të gjitha elementeve, mungojnë si ana objektive, ashtu edhe ajo subjektive e veprave të lartpërmendura.

Nuk u provua në asnjë rast asnjë lidhje midis veprimeve të institucioneve të ndryshme dhe pasojës apo pasojave të dyshuara, që kanë ardhur sipas hetimit të SPAK-ut në këtë procedurë. Veprimet e institucioneve apo funksionarëve të ndryshëm kanë qenë të pavarura nga njëra-tjetra, të kryera si detyrim për shkak të ligjit organik, apo të lidhura me përgjegjësinë funksionale dhe jo si pasojë e ndonjë bashkëpunimi të veçantë në formën e një grupi të strukturuar, krijuar apo urdhëruar posaçërisht dhe për qëllime të fitimit pasuror.

Akuzat e opozitës në këtë drejtim janë veçse shpifje, që synojnë të dezinformojnë opinionin publik, për të marrë prej tij kredo publike, në rastin që gara e partive politike, një garë e konfirmuar sot në fakt, duhet të bazohet vetëm në oferta prej politikash të ndershme, të udhëhequra nga interesi publik, sikundër edhe nga aktorë, që gëzojnë mbështetje dhe kanë integritet të provuar, reputacion besueshmërie.

Puna për projektin e impiantit të Elbasanit ka filluar me propozimin e pakërkuar në korrik të vitit 2014 dhe kontrata është lidhur më 16 dhjetor 2014, 5 muaj më vonë. Ky fakt hedh poshtë çdo alibi të ngritur nga Partia Demokratike që në shërbim të këtij projekti u vendos e gjithë qeveria dhe jo vetëm, por edhe pushteti lokal. Nga dokumentacioni dhe dëshmitë u vërtetua se në mbledhjen e datës 17 dhjetor 2014 është miratuar vetëm një vendim, vendimi nr. 907 “Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të

kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan dhe prodhimin e energjisë” dhe jo 17 vendime për këtë rast, sikurse padrejtësisht, në fakt, është informuar publiku.

U hodh poshtë fakti që ministri Cani nuk kishte dhënë miratimin për mbështetjen financiare të impiantit të trajtimit të mbetjeve të Elbasanit dhe për këtë arsye u largua edhe nga detyra. Kujtojmë se zoti Cani, pas një sërë komunikimesh me Ministrinë e Mjedisit, me shpresën e protokollit nr.17042/1, datë 10 dhjetor 2014 ka dhënë dakordësinë për mbështetjen financiare të propozuar në studimin e fizibilitetit, në një dakordësi, në fakt, që ai e shpjegoi shumë mirë edhe gjatë dëshmisë së tij në komisionin parlamentar, pa e vënë asnjë rast në dyshim.

Procedurat e ndjekura për miratim nga Këshilli i Ministrave të vendimit nr.907, me anë të të cilit është vendosur dhënia e miratimit të financimit për impiantin e Elbasanit kanë qenë konform legjislacionit dhe në përputhje të plotë edhe me ligjin nr. 9000, të vitit 2003, që është ligji mbi bazën e të cilit vepron Këshilli i Ministrave. Bazuar në nenin 9 të ligjit nr.9000, të vitit 2003, ku përcaktohen kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, dhe më tej në disa nene të tij, si: 13, 15, 16, saktësohet se kjo VKM i plotësonte të gjitha kriteret për t’u kaluar dhe për t’u miratuar nga Këshilli i Ministrave, pasi akti në vetvete kishte një autorizim ligjor të mirëpërcaktuar në nenin 41, pika 2, të ligjit “Për koncesionet dhe partneritetet publike private”.

Konform ligjit u provua të ketë qenë edhe vendimmarrja tjetër e Këshillit të Ministrave në lidhje me këtë kontratë koncesionare, e shprehur në vendimin nr. 792, të 9 nëntorit 2016, që me anë të këtij vendimi është dhënë miratimi për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit për rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit. Një vendim në favor të shoqërisë “Albtec Energy”.

Sikurse u sqarua nga dokumentacioni, por edhe nga dëshmitarët, kjo vendimmarrje nuk përfaqëson një koncesion të ri, por është autorizim i ndërtimit të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike dhe lidhjes me rrjetin. Në fund apo në përfundim të afatit të kontratës koncesionare të Elbasanit (unë ju ftoj të gjithëve të shikoni nenin 26 të kësaj kontrate koncesionare) parashikohet qartësisht që çdo leje dhe çdo licencë i transferohet autoritetit shtetëror në përfundim të afatit 7-vjeçar. Pra, impianti në përfundim të afatit 7-vjeçar i kalon Bashkisë së Elbasanit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, pra është një aset i Bashkisë Elbasan, të cilin kjo bashki do të duhet ta operojë në formën e parashikuar nga ligji.

Të vijmë te praktika koncesionare e Fierit. Më lejoni që edhe këtu t’ju jap të dhënat kryesore të kësaj kontrate koncesionare. Edhe këtu autoritet kontraktor është Ministria e Mjedisit, koncesionar rezulton të jetë “*Integrated Technology Waste Treatment Fier*”. Forma e koncesionit ka qenë e njëjtë, ndërtim operim dhe pastaj transferim. Data e lidhjes së

kontratës është data 24 tetor 2016. Periudha e koncesionit për këtë kontratë është 6 vjet. Vlera e kontratës është 28 milionë euro dhe vendndodhja (pra nuk ka një vendndodhje të përcaktuar në kontratë) shesh i miratuar me vendim të këshillit bashkiak.

Përpjekja për ndërtimin e këtij impianti ka filluar që në vitin 2015. Edhe në Fier, ish-fusha ku trajtoheshin, trajtoheshin është një fjalë e madhe, sepse aty thjesht hidheshin, pra ku hidheshin mbetjet në Bashkinë e Fierit, e cila pas vitit 2015, si 60 bashkitë e tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë, i zgjeroi shumë përmasat e veta për shkak të reformës territoriale administrative, doli jashtë funksionit për të cilin ishte parashikuar që në vitet e regjimit komunist.

Në lidhje me impiantin e Fierit është ngritur pretendimi që zgjatja e tij ka qenë një zgjatje abuzive, le të themi. Të gjithë ne, media, së pari, kemi qenë dëshmitarë se për ngritjen e këtij impianti ka pasur protesta, për të cilat është provuar që ishin të frymëzuara edhe nga përfaqësuesit politikë të opozitës, të cilët me kast u bënë protagonist të këtyre protestave. Ndërkohë, pas zgjedhjeve të vitit 2017, kohë kur u prish edhe koalicioni qeveritar i vitit 2013, u shtuan edhe përfaqësuesit politik të LSI-së. Pas zgjedhjeve të vitit 2017 pjesë e organizimit të këtyre protestave u bënë përfaqësuesit të PD-s dhe LSI-së. Ky fakt rezulton i provuar qoftë nëpërmjet materialeve të ndryshme audiovizive, por edhe materialeve fotografike, që ne na u vunë në dispozicion gjatë dëshmisë së kryetarit të Bashkisë Fier, zoti Subashi.

Pa dyshim të gjitha këto situata e vonuan zhvillimin e projektit, por sot mund të themi se ky është një projekt që vijon të jetë brenda termave të afatit kontraktorë. Është një projekt jashtëzakonisht i vlefshëm. Jo më kot e lexova datën e lidhjes së kontratës, për të kuptuar që jemi brenda afateve të kontratës.

Aktualisht bashkitë e Fierit, Lushnjës, Roskovecit dhe Patosit, në kohë të shkurtër të këtij projekti do t'i bashkohen edhe bashkitë e Divjakës dhe Madhakastrës, i depozitojnë mbetjet e tyre sot që flasim, ku nuk bëhen pak, por 170 deri në 180 tonë mbetje çdo ditë, në këtë impiant, për të cilin, në kundërshtim me sa thuhet, është shpallur gara rregullisht, duke u bërë njoftimet në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Ish-fusha e mbetjeve në Fier është e kapsoluar, është rehabilituar në masën mbi 70% dhe janë mbjellë disa mijëra pemë në atë fushë. Mbetjet e Bashkisë Fier, përfshirë këtu edhe 9 njësitë administrative të saj, pasi mblidhen me mjete ekologjike, nëpërmjet një stacioni transferimi, që është ngritur nga vetë Bashkia e Fierit, me financat e saj, me anë të dy mjeteve të tonazhit të lartë, transportohen në impiant, aty ku bëhet depozitimi dhe përpunimi i mbetjeve që vijnë ndërkohë edhe nga bashki të tjera, siç e thamë: nga Lushnja, Patosi dhe Roskoveci.

Pozicioni gjeografik i këtij impianti është i përshtatshëm, që edhe bashki të tjera të qarkut Fier, si Divjaka dhe Mallakastra, por edhe bashkitë e qarkut Berat, si Diman dhe

Kuçovë dhe vetë bashkia Berat mund ta konsiderojnë këtë impiant si një zgjidhje optimale për trajtimin e mbetjeve urbane në territorin e tyre, sigurisht duke vlerësuar më parë të gjitha kostot, kjo është e rëndësishme.

Parimi: “Kush ndot, paguan” është një parim, të cilin duhet ta kuptojmë dhe ta vlerësojmë drejt, nëse duam vërtetë një mjedis të pastër për veten dhe brezat që do të vijnë.

Proceset e menaxhimit të integruar të mbetjeve janë procese komplekse, që kërkojnë njohuri shkencore dhe jo vetëm, kërkojnë përditësim të këtyre njohurive, teknologji të mirë, por edhe financa të mira, të qëndrueshme dhe të konsoliduara. Kjo, sigurisht që është një përgjegjësi shtetërore.

Sa më lart, do të thotë që administrimi i mëtejshëm i impianteve, siç do të vijojë, nga ana e bashkive Elbasan, Fier, por edhe Tiranë, që është në një kohë më të vonë, do të jetë një sfidë, por edhe një mundësi e mirë për këto bashki, që ato të krijojnë të ardhura nëpërmjet diferencimit të mbetjeve, kostifikimit të tyre dhe prodhimit të energjisë.

Nga dëshmitë e kryetarëve të bashkive Fier dhe Elbasan rezultoi qartë se institucionet që ato drejtojnë kanë hyrë tani më në rrugën e marrjes përsipër të këtyre përgjithësive, konkretisht, sepse, nëse një herë pohuan që kishin marrë kontakt nga përfaqësues të kompanisë, kanë marrë paraprakisht çdo masë të nevojshme për të siguruar miradministrimin në funksion të një zgjidhje, flas për një zgjidhje me standarde, që i përgjigjet nevojës që kemi të gjithë, për një mjedis të pastër dhe një higjienë të përshtatshme.

Për disa përfundime të procedurës së Fierit, duke pasur parasysh edhe pretendimet që janë ngritur nga ana e opozitës.

Në procedurën e ndjekur nga Bashkia Fier nuk ka pasur shkelje të ligjit për sa i përket ushtrimit të kompetencave të veta nga organet kryesore të kësaj bashkie, kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak. Të gjitha vendimet për përcaktimin e vendit se ku do të ndërtohet impianti janë marrë hap pas hapi nga këshilli i bashkiak dhe shumica e këtyre vendimeve, sikundër provohet edhe nga dokumentacioni shkresor, janë marrë me unanimitet të të gjithë këshilltarëve. Nga ky hetim rezulton se kryetari i bashkisë nuk ka disponuar për këtë çështje pa marrë miratimin e këshillit në asnjë rast.

Nga opozita është ngritur pretendimi se ndryshimi i vendit të ndërtimit të këtij impianti, madje jo vetëm është ngritur pretendim, por është bërë edhe kallëzim për këtë, është bërë pa vendim të këshillit bashkiak, e cila rezultoi e pavërtetë nga hetimi i kryer nga ky komision.

Gjithashtu, i pavërtetë rezultoi edhe pretendimi tjetër i opozitës se ndryshimi i vendimit nga një pronë shtet në një pronë private, i ka shkaktuar shtetit një dëm ekonomik në vlerën e 46 milionë lekëve.

Nga hetimi rezultoi e provuar se në asnjë nga vendimet e këshillit bashkiak nuk ka qenë e parashikuar që impianti të ndërtohet në tokë shtet. Edhe kur diskutohej për fshatin Mbyet të njësisë administrative të Portëz, fjala ishte që ndërtimi do të bëhej në tokë private, sepse toka atje rezulton private, me përjashtim të rrugëve lidhëse ndërmjet parcelave, të cilat janë pronë publike dhe jo pronë private.

Këtë moment e sqaroi shumë mirë kryetari i Bashkisë Fier, por përtej dëshmisë që u dha nga kryetari i Bashkisë Fier, ne kemi administruar vendimin e këshillit bashkiak, i cili, para se të evidentoheshin problemet në zonë kadastrale të fshatit Mbyet evidentonte angazhimin e marrë përsipër nga këshilli i Bashkisë Fier që të fillonte procedurat e shpronësimit publik në atë fshat. Atëherë, kuptohet qartësisht se asnjëherë nuk është bërë fjalë që ky impiant po ndërtohet në ndonjë tokë publike, përkundrazi, vendet e sugjeruara kanë qenë tokë private, dhe për këtë arsye është dashur të bëhet edhe shpronësimi.

Sipërfaqe të shprehura në fillim në njësinë administrative Portës, zona kadastrale 3000, fshati Plyk, apo edhe saktësimi që thamë, zona kadastrale 2637 në fshatin Mbyet, nuk rezultuan të ishin toka shtet. Ato ishin toka bujqësore, që me ligjin nr. 7501 iu ishin ndarë fermerëve të këtyre fshatrave dhe në 30 vjet e më shumë, qëkurse kishte filluar veprimi i këtij ligji, këto toka ishin mbjellë, kultivoheshin nga fermerët dhe për këtë arsye, nëse do të shpronësoheshin, do të kishin një vlerë jo të vogël, sepse nuk shpronësohet thjesht toka, por edhe vlera e pasurive të krijuara mbi to, vlera e mbjelljeve apo pemëve drufrutore që rezultojnë të mbjella aty.

Po kështu, mund të themi se pavarësisht pretendimeve të opozitës, Bashkia Fier rezulton ndërkohë të jetë bërë pronare e sipërfaqes së tokës së shpronësuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 951 të vitit 2016 dhe nuk është një sipërfaqe e vogël, që i referohet impiantit në vetvete, por është një sipërfaqe prej 111 mijë e 564 metër katrorë. Mbi këtë bazë Bashkia Fier rezulton t'i ketë shtuar asetet e veta, jo t'i ketë pakësuar. Pra, është krejt e qartë që nuk mund të pretendosh dëm ekonomik apo financiar kur një ent publik, për më shumë, një bashki, nëpërmjet një shume të caktuar monetare, shton asetet e veta me pasuri të paluajtshme, siç është kjo sipërfaqe e tokës, ku funksionon sot impianti i Fierit.

Të gjitha problematikat e ngritura sot, nga aktorë të ndryshëm politikë ose jo, lidhur me parregullsi të pretenduara në këtë proces, kanë qenë objekt i shqyrtimit dhe hetimit gjyqësor nga Gjykata Administrative. Në gjykimin e zhvilluar, qoftë në Shkallën e Parë, qoftë të Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, që është e vetmja Gjykatë e Shkallës së Dytë në territorin e Republikës së Shqipërisë për çështjet administrative, është pretenduar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të deklaratës mjedisore dhe i lejes së ndërtimit. Në vendimin e tyre këto gjykata kanë arsyetuar se përpara nxjerrjes së lejes mjedisore dhe lejes së ndërtimit nga

ana e autoritetit kontraktor, Ministria e Mjedisit, janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme, përfshirë edhe dëgjesat me banorët e zonës.

Diskutimi pse shpronësimi është bërë mbi tokë truall dhe jo mbi tokë arrë, gjen po ashtu përgjigje në këtë vendim që unë po referoj, vendimi i Apelit Administrativ, që ka lënë në fuqi edhe vendimin e Shkallë së Parë, dhe kjo sipërfaqe toke e ka ndryshuar kategorinë e vetë jo pa lidhje fare, por sepse ishte miratuar plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Fier, një plan i konfirmuar nga prefekti i qarkut Fier, një plan i konfirmuar edhe me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.

A mund ta vëmë ne në diskutim këtë vendim gjyqësor të formës së prerë, duke e injoruar, duke mos e njohur, duke mos e zbatuar, duke bërë sikur nuk ekziston, thjesht dhe vetëm për interesin politik që kemi në këtë komision hetimor parlamentar, apo për shkak të një agjende të presupozuar, të paracaktuar? Sigurisht që jo. Ky është vendim gjyqësor i formës së prerë dhe si i tillë, nuk mund të vihet në zbatim. Është e vërtetë që në vitet 2017-2018 ky vendim nuk ekzistonte, sepse ka marrë formë të prerë më vonë, por faktet që ai konstaton, faktet që ai sanksionon në përmbajtje të tij, janë fakte të detyrueshme për t'u marrë parasysh nga të gjithë.

Neni 3 i ligjit "Për komisionet hetimore" parashikon që komisioni hetimor nuk mund të ngrejë akuza penale dhe as të ushtrojë atributet e gjykatave. Pra, është e qartë që përballë një vendimi gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, ky komision hetimor, por edhe Kuvendi i Shqipërisë, nuk mund të marrin atributet e një gjykate më të lartë, duke mos njohur apo duke ndryshuar fakte, prova apo konkluzione të provuara dhe të sanksionuara në këtë vendim gjyqësor.

Në nenin 4, pika 1 e Kushtetutës sanksionohet se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimit të shtetit.

Në nenin 7, e përmendëm që në krye të herës, sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen e pushteteve.

Ndërkohë, neni 142 i Kushtetutës thotë shprehimisht: "Organet e shtetit janë të detyruara t'i ekzekutojnë vendimet gjyqësore". Kuptohet se për t'i ekzekutuar, duhet t'i njohësh. Nga pikëpamja kushtetuese është e qartë se vendimi kushtetues i formës së prerë nuk mund të mos zbatohet nga komisioni në përgatitjen dhe miratimin e një raporti apo edhe nga Kuvendi i Shqipërisë në miratimin e tij në seancë plenare.

Nga gjithë sa më lartë, as vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 951, datë 28.12.2016 nuk mund të vihet në diskutim, pasi gjykata, duke argumentuar ligjshmërinë e kësaj VKM-je, në ndryshimin e kategorisë së tokës, ka gjetur të vlefshme edhe lejen e ndërtimit që është dhënë për impiantin e trajtimit të mbetjeve në Fier.

Të vijmë te praktika e fundit, praktika koncesionare e Tiranës.

Cilat janë të dhënat kryesore të kësaj kontrate koncesionare, dhe ky është një koncesion i pastër, në ndryshim nga Fieri dhe Elbasani, që janë partneritete publike private.

Autoritet kontraktues: Ministria e Mjedisit.

Koncesionari Integrated Energy BV SPV sh.p.k

Kontrata e koncesionit është e formës bot.

Data e lidhjes së kontratës rezulton të jetë 31 gusht 2017. Periudha e koncesionit 30 vjet. Vlera e kontratës 128 milionë euro, vendndodhja Sharrë.

Gjatë kohës që jemi duke folur për këto impiante, unë dua të sjellë në vëmendjen tuaj që sigurisht puna ka nisur dhe ka funksionuar mbi bazën e një legjislacioni mbi të cilin ka vepruar edhe një qeverisje e mëparshme, qeverisja e mëparshme e vitit 2013, që nuk ishte një qeverisje e majtë. Ndërkohë, pas këtyre viteve, për shkak të praktikitet të punës, ne kemi ndërhyrë në legjislacion dhe mund të thuhet realisht që në legjislacionin për sa u takon koncesioneve dhe partneriteteve publike-private është bërë progres, sepse ky legjislacion është përmirësuar. Mbase kjo nuk është vetëm meritë e qeverisjes sonë, por është edhe meritë e faktit që Bashkimi Europian në vetvete ka ndryshuar direktivat në fushë dhe për këtë arsye ne kemi pasur dhe kemi detyrimin që legjislacionin ta përditësojmë.

Kështu, një ndër nismat më të rëndësishme të ndërmarra nga qeverisja jonë është ajo e datës 6 nëntor 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet””. Synimi i këtij projektakti ishte të përmirësonte kuadrin ligjor, mënyrën e zbatimit të procedurave për dhënien e koncesioneve, PPP-ve, dhe të rriste kontrollin mbi angazhimet fiskale të marra përsipër nga autoritetet kontraktore nëpërmjet kontratave të koncesionit, me qëllim minimizimin e impaktit fiskal në buxhetin e shtetit, bazuar edhe në rekomandimet që kanë dhënë institucionet e ndryshme ndërkombëtare, të cilat kanë asistuar lidhur me financat, si FMN-ja, Banka Botërore, SIGMA-OECD-ja. Këto ndryshime janë bërë edhe në harmoni të plotë me ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

Çfarë përfshin iniciativa për ndryshimin e ligjit “Për koncesionet”, e ndërmarrë në vitin 2018? Përfshin heqjen e propozimeve të pakërkuara për një sërë sektorësh. Këtu ajo që na intereson, është të vëmë në dukje që është hequr propozimi i pakërkuara në lidhje me projekte që i referohen trajtimit dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ky ndryshim ndërkohë vinte në harmoni edhe me direktivën e Komisionit Europian, që është direktiva e vitit 2014/23 “Për dhënien e kontratave të koncesionit”.

2. U hoq bonusi për propozimet e pakërkuara.

Me qëllim rritjen e transparencës dhe trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët në procedurën konkurruese, u hoq mekanizmi i bonusit ndaj/ose për të gjithë operatorët që deri në atë kohë në rastin që paraqisnin propozime të pakërkuara kishin të drejtë të përfitonin

bonus. Pra, me anë të këtyre ndryshimeve u përcaktua se pas datës 1 korrik 2019 nuk do të kishte më sistem të shpërblimit me pikë bonus dhe për të nxitur sektorin privat, që, sigurisht, duhej të ishte pjesëmarrës në sipërmarrje të tilla, sistemi me pikë bonus u zëvendësua me atë të kompensimit në vlerë monetare të propozuesit, një kompensim që shkon deri në se 1% të vlerës së investimit, jo më shumë se kaq. Mekanizmi i propozuar i kompensimit nuk cenon konkurrencën, përkundrazi e ruan konkurrencën.

Ndërkohë, me ndryshimet e kërkuara në këtë ligj u kërkuara të forcohej edhe roli i ministrit përgjegjës për Financat. Qëllimi ishte përcaktimi i qartë i rolit dhe përgjegjësisë së këtij ministri në projekte të tilla, projekte koncesionare, PPP, në pikëpamje të implikimeve financiare, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Besoj se të gjitha këto ndryshime kanë qenë të detyruara nga fakti që dihet se projektet e koncesionit janë projekte komplekse, nuk janë projekte të thjeshta, janë projekte afatgjata, kanë realisht një sërë risqesh dhe detyrimesh. Kështu që është e nevojshme që të gjitha këto projekte, si ato me mbështetje dhe ato pa mbështetje financiare, pas viti 2018 të paraqiteshin në ministrinë përgjegjëse për Financat për vlerësim dhe miratim, gjithmonë nga pikëpamja fiskale.

Ndërkohë, do të kaloj në një moment tjetër. Kalojmë edhe një herë te ligji që përcakton organizmin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, sepse në këtë komision janë ngritur akuza për të gjithë anëtarët e Këshillit të Ministrave, për sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për Kryeministrin, duke iu referuar një procedure rutinë të zbatuar gjerësisht nga të gjitha qeverisjet që është ajo bashkërendimit të akteve.

Procedura e konsultimit midis ministrive, e njohur si bashkërendimi i akteve, është procedurë rutinë pune, nuk është një procedurë që të amplifikohet sikur në rastin e këtyre impianteve kjo procedurë qenka bërë enkas nga kjo qeveri. Për çdo vendimmarrje që ka marrë, që merr që do të marrë Këshilli i Ministrave sigurisht që duhet të zhvillohet kjo procedurë, sepse e përcakton ligji dhe jo diskrecioni i dikujt në përbërje të Këshillit të Ministrave. Pa dyshim që është një punë, që e detyron ligji dhe ligji detyron përfaqësuesit, kabinetet dhe institucionet e ndryshme qendrore që të përfshihen në këtë proces konsultimi përmes vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre. A mund të penalizohet dikush për mendimet, për sugjerimet dhe për vërejtjet që bëjnë në një proces rutinë pune? Përgjigjen e kësaj pyetjeje, përpara se ta jap unë në emër të anëtarëve të këtij komisioni, e ka dhënë Kushtetuta që në vitin 1998 në nenin 22 të saj, ku sanksionon garantimin e lirisë së shprehjes për të gjithë.

Si merren vendimet në mbledhjet e Këshillit të Ministrave? Anëtarët e Këshillit të Ministrave duhet t'i respektojnë vendimet e marra në mbledhjet e qeverisë, e kanë detyrim ligjor. Ata duhet mënjanojnë në mënyrë të veçantë çdo shprehje mospajtimi, të mbrojnë ose

të përkrahin vendimet e lartpërmendura, pavarësisht nga fakti nëse kanë qenë apo jo në mbledhje apo kanë votuar pro ose kundër. Këshilli i Ministrave është organ kushtetues, është organ kolegjal për nga mënyra si funksionon dhe pikërisht se është i tillë duhet të shfaqet unitare në vendimmarrjen e tij, pavarësisht debateve dhe vlerësimeve të ndryshme që eventualisht dhe me të drejtë anëtarët e qeverisë mund të ruajnë për vendime ose çështje të ndryshme. Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten konfidenciale. Këtë thotë ligji i Këshillit të Ministrave i vitit 2003. Ky adresim në parashikime të tilla ligjore vlen për të rrëzuar çdo pretendim të opozitës për qenien në konflikt interesi të anëtarëve përfaqësues të maxhorancës në këtë komision hetimor dhe që më herët kanë mbajtur detyrën e ministrave në qeverisë paraardhëse, sikundër njëherazi tregon se nuk ka pasur asnjë urdhër të shprehur apo të nënkuptuar, i cili të impononte një vendimmarrje të caktuar dhe dakordësi nga ana e të gjithëve në linjë vertikale nga këshillat bashkiakë, kryetarët e bashkive të secili ministër, të kabinetet e çdo ministri për të ardhur të Këshilli i Ministrave në tërësi dhe Kryeministri. Ajo që është më e rëndësishmja për t'u theksuar, është që kontrata e inceneratorit të Tiranës nuk është PPP, por është koncesion i pastër, e cila nuk kërkon mbështetje financiare. Tirana është një koncesion i formës "Paguaj për të përdorur" (*pay for use*), një kontratë me një tarifë shërbimi, ku bashkitë, ato që operojnë në këtë impiant, paguajnë tarifën 29 euro për ton.

Impianti i Tiranës nuk ka kërkuar mbështetje financiare në kontekstin e nenit 42 të ligjit "Për koncesionet", pasi është një investim tërësisht privat prej 128 milionë eurosh, ku aset i pas 30 vjetëve do t'i transferohet Bashkisë së Tiranës. Ky shpjegim u bë në komisionin hetimor nga ish-ministri i Financave, zoti Ahmetaj, i cili shpjegoi qartë se vlerësimi i bërë nga ana e Ministrisë së Financave nuk u është referuar parashikimeve ligjore të nenit 42 të ligjit "Për koncesionet", pasi ky nen parashikon se projekti që ka nevojë për mbështetje financiare, siç përcaktohet nga studimi i fizibilitetit, kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave.

Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një projekt që kërkon mbështetje financiare, sipas modelit financiar pagesa disponueshmërie, të cilat, sipas terminologjisë së PPP-ve, është një formë e zakonshme e pagesës në PPP-të e tipit "qeveria paguan" dhe që kanë bëjnë me pagesat që bëhen gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës në këmbim të të cilave pala private vë në dispozicion infrastrukturën, asetin.

Sipas kësaj kontrate, janë bashkitë ato që paguajnë shërbimin, duke kryer në këtë rast edhe funksionet që ato i kanë, sipas ligjeve të veta organike. Në Sharrë do të ndodhë edhe incerimi i mbetjeve të papërdorshme, ju kujtoj që ne në rastin e Tiranës jemi ende brenda zërave të kontratës. Për çdo ton mbetje urbane që dërgohet në Sharrë sot nga bashkia Tiranë, por edhe bashkitë e Durrësit dhe Kavajës paguhet kjo tarifë, 29 euro për ton. A është kjo një tarifë disproporcionale krahasuar me tarifa shërbimi të tjera?

Në komisionin hetimor nga të dhëna të ndryshme statistikore që u administruan konstatohet lehtësisht që kjo është një tarifë e përafërt për shërbimet e trajtimit të mbetjeve urbane kudo në Europë dhe ku funksionojnë impiante të tilla. Për provueshmërinë në këtë rast ne na ka ndihmuar edhe administrimi i një informacioni nga ana e bashkisë Tiranë, për kohën kur kjo bashki drejtohej nga zoti Basha. Në atë rast është bërë një studim me Bankën Botërore dhe ky propozim propozonte tarifën 37 euro për ton mbetje, bëhej fjalë jo për impiant, ku përfshihet brenda edhe landfilli dhe incerimi, por bëhej fjalë vetëm për landfill dhe 37 euro për ton nga 29 euro për ton.

Për të provuar shkelje të ndryshme të pretenduara në të tri këto procedura koncesionare shpeshherë u përmendën raporte të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Pa dyshim që Kontrolli i Lartë i Shtetit është një institucion i rëndësishëm kushtetues, që duhet të jetë i pavarur, por e vërteta është që ish-kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nënshkruet i këtyre raporteve, që i ka bërë referencë opozita, dje një ministër në kohën kur qeveriste PD-ja dhe sot deputet i Partisë Demokratike, sigurisht që këto nuk mund të flasin për integritet të këtyre akteve dhe për pacenueshmëri, ndërkohë që në anën tjetër aktet e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë akte administrative dhe nuk janë vendime gjykate të formës së prerë, ato janë akte që kontestohen në rrugë administrative dhe gjyqësore. Në rastin konkret ky është organi më i lartë, nuk ka organ epror, kështu që kontestohen direkt pas objeksioneve që bëjnë organet e administratës në gjykatë.

Mospërmbushjet e detyrimeve kontraktore, që janë referuar shpeshherë edhe në rastin e këtyre kontratave koncesionare, pa dyshim që duhet të trajtohen civilisht, përderisa nuk provohet dhe nuk u provua në asnjë rast në këtë komision hetimor që ato përbëjnë veprë penale, për shembull vonesat në disa zëra të kontratave. Ka qenë dhe ngelet detyrim i Kontrollit të Lartë të Shtetit që, nëse gjatë auditimit të kontratave koncesionare ka ndeshur shkelje që përbëjnë vepra penale, t'i kallëzonte ato në organin e prokurorisë, por, në fakt, në këtë komision nuk na u vu në dispozicion asnjë dokument që të tregonte që në vijim të raporteve të përgatitura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për këto procedura koncesionare të jetë depozituar edhe ndonjë kallëzim penal në organin e prokurorisë.

Kam edhe diçka tjetër që doja ta shtoja në fjalën time. Në zbatim të detyrimeve të këtij komisioni hetimor dua t'ju them se ne kemi qenë të vëmendshëm edhe në drejtim të njohjes së praktikave europiane të menaxhimit të mbetjeve, sikundër disa herë ne e përdorëm për referencë, ndërkohë që opozita e përdor si provë të akuzave të saj publike.

Referuar publikimeve shkencore rezulton se sot në nivel global gjenerohen mbi 2 miliardë tonë mbetje në vit. Shekuj më parë, një mendje universale deklaronte se ajo që për ne sot është mbetje, nesër do të jetë lëndë e parë. Përvoja europiane tashmë e ka vërtetuar këtë pohim, ndaj prioriteti i Bashkimit European është tek ekonomia qarkulluese që ka për

synim reduktimin e mbetjeve dhe riciklimin. Në modelin e ekonomisë qarkulluese, prodhimi i energjisë nga djegia e mbetjeve radhitet në vendin e katërt.

Prioritet është parandalimi i gjenerimit të mbetjeve; i dyti është ripërdorimi; i treti është riciklimi dhe pastaj vjen incenerimi.

Faktikisht, ky proces na është përshkruar në të gjitha impiantet ku kemi shkuar.

Kuadri ligjor i BE-së rregullohet dhe ndryshon në funksion të prioriteteve, duke kufizuar djegien vetëm për ato mbetje, të cilat nuk mund të përdoren më. Në nivelin e Bashkimit Europian përjashtet e shteteve anëtare janë të ndryshme për sa i takon riciklimit apo djegies. Danimarka është kampione e djegies, ajo riciklon rreth 50%, 1% e dërgon në landfill, pjesën tjetër e djeg.

Në Bashkimin Europian përgjatë viteve 1995-2019 është zvogëluar depozitimi i mbetjeve në landfille nga 121 milionë tonë në 53 milionë tonë. Sasia e mbetjeve të ricikluara dhe të kompostuara nga 37 milionë tonë në vitin 1995, u rrit në 107 milionë tonë në vitin 2019, ndërkohë që vetëm për djegien, mund t'ju them se në të njëjtën periudhë kohore 1995-2019, rezulton që djegia është rritur dyfish, nga 30 milionë tonë, sot është 60 milionë tonë.

Sot në Bashkimin Europian janë në punë rreth 500 inceneratorë.

Cila mënyrë e menaxhimit është më e mira? Është riciklimi, djegia, depozitimi apo landfili? Sigurisht që këtë nuk e vendosim ne në këtë komision hetimor, por shpresoj që këtë ta vendosin dhe ta përmirësojnë ekspertët mjedisorë, të vetmit, në fakt, që nuk u dëgjuan në këtë komision hetimor, por me gjasë publiku ka pritur të dëgjonte njerëz të tillë. Sigurisht, rolin e ekspertëve mjedisorë nuk mund ta bëjnë anëtarët e partive politike, mua më vjen keq që të paktën publiku u privua nga kjo e dhënë. Kjo ishte një arsye pse u përpoqa që në këtë raport që ne bëmë së bashku me kolegët të sillja edhe një të dhënë të marrë nga punime shkencore, nga njerëz që njihen si ekspertë mjedisorë.

Praktika ka treguar se menaxhimi i mbetjeve nuk është si recetat e gatimit. Një model që funksionon në një vend nuk është e thënë që funksionon edhe diku tjetër po njësoj. Kombinimi në masën e duhur i formave të menaxhimit, duke pasur parasysh kriteret mjedisorë, ekonomike, të tregut, të shëndetit të njeriut dhe ato të zhvillimit të qëndrueshëm do të çonte në zgjidhje optimale. Menaxhimi më i mirë është ai ku kombinohen të gjitha këto mënyra.

Vende të pasura me sipërfaqe toke, dhe kjo është logjike, u kanë dhënë përparësi landfilleve. Vende që i kanë këto sipërfaqe të kufizuara, Europa në përgjithësi ka sipërfaqe toke të kufizuara, i kanë dhënë përparësi riciklimit dhe djegies, ndërkohë këto vende pothuajse po i eliminojnë landfillet.

Si anë pozitive të inceneratorëve përmendet reduktimi i vëllimit të mbetjeve deri në 90%, djegia plotësisht e një pjese të lëndëve toksike, prodhimi i energjisë dhe avullit, si edhe

mundësia për të rikuperuar metalet. Këtë, në fakt, e pamë edhe në impiantet si funksiononte mekanizmi i tërheqjes së metaleve, kur shkuam t'i vizitonim.

Mbetjet nuk janë problem vetëm i qeverisë, por edhe i qytetarëve edhe i edukimit të tyre. Sigurisht që kjo është një çështje që vazhdon të ketë debat te ne, do të kërkojë angazhim, do të kërkojë edhe më shumë vëmendje edhe më shumë përgjegjësi të shtuar në administrimin, siç duhet, do të kërkojë ligj dhe standardizim më të mirë të procedurave të ndjekura për të optimizuar përfitimet dhe për të ulur kostot, për të siguruar një cilësi të mirë të mjedisit.

Shuma prej 430 milionë eurosh, e supozuar si abuzim i shekullit, nga Partia Demokratike nuk ekziston. Si nga dokumentacioni i administruar në komisionin hetimor, edhe nga dëshmitë që u morën në këtë komision u provua se shifra prej 430 milionë euro është një shifër e pavërtetë, e cila pati dhe si qëllim të vetëm keqinformimin e publikut dhe nxitjen e tij për të menduar se kjo shumë është e lidhur me një grup të strukturuar kriminal. Shuma e paguar nga buxheti i shtetit në total është rreth 55 milionë euro. E faktuar kjo nga autorizimet përkatëse që na ka vënë në dispozicion Thesari i Shtetit. Në këtë shumë përfshihet pagesa e plotë për impiantin e trajtimit të mbetjeve për qarkun e Elbasanit në një total prej 21,6 milionë euro pa TVSH, veprë e ndërtuar dhe në funksion të të gjitha impianteve dhe që prodhonte energji elektrike, siç e thamë; një pjesë e pagesës për impiantin e ngritur në Fier që ka vlerë prej 28 milionë euro pa TVSH, veprë e ndërtuar e vënë në funksion më përjashtim të impiantit të energjisë elektrike për të cilin ende nuk janë paguar rreth 5 milionë euro. Nëse pagesa e plotë e kryer nga viti 2014 deri tani nga buxheti i shtetit për ndërtimin e dy veprave është në total rreth 55 milionë euro, atëherë si ka mundësi që Partia Demokratike flet për shumën stratosferike 430 milionë euro? Në komision nuk u soll ndonjë provë dokumentare që ta faktonte këtë gjë. Opozita pohoi se kjo shifër është e parashikuar në kontratën e koncesionit të Tiranës, duke iu referua tabelës përmbledhëse të punimeve. Pra, sipas kësaj logjike shuma që do të paguajnë bashkitë e qarkut të Tiranës për 30 vjetët e ardhshëm për pagesën e tarifës së shërbimit prej 29 euro, do të jetë rreth 300 milionë euro. Kësaj shume i shtojmë edhe shumën e investimit që bën investitori privat, sepse është koncesion i pastër Tirana dhe koncesionari duhet të investojë 128 milionë euro, po i marrim 130, vetëm mbledhja e këtyre dy shifrave të çon në shifrën 430 milionë euro. Mënyra e bërjes së llogarive nga PD-ja ose është paaftësi, por dyshoj që është kështu, ose është dashakeqësi dhe në rastin konkret ne mendojmë që prevalon kjo e dyta. Kontrata e koncesionit është 30-vjeçare dhe shuma totale prej 300 milionë eurosh do të paguhet nga bashkitë deri në vitin 2047. Fakt ky që Partia Demokratike me qëllim nuk ia thotë opinionit publik. Në shumën 430 milionë euro janë futur edhe shpenzimet e ndërtimit prej rreth 130 milionë euro që do të kryejë subjekti privat, sepse ky është një investim që do të kryhet në

Tiranë nga privati dhe jo nga buxheti i shtetit. Nga të gjitha sa sqaruam më sipër kuptohet qartë se opinioni publik është dezinformuar në mënyrë të përsëritur nëpërmjet deformimit të shifrave dhe fakteve si dhe atribuimit të disa akuzave penale ndaj funksionarëve të ndryshëm shtetëror me qëllimin e qartë për të fituar kredo politike.

Në lidhje me përcaktimin e tarifave të dherave që ka qenë edhe ky një moment që u diskutua në komisionin hetimor nga këshilli bashkiak i Tiranës, edhe kjo është një çështje jashtë kompetencave të këshillit bashkiak të Tiranës, dhe kjo bazohet qartësisht në parashikimet e nenit 54 të ligjit për vetëqeverisjen vendore, të ligjit nr. 68 për financat e vetëqeverisjes vendore, madje ka disa nene në to që sqarojnë qartësisht që Bashkia e Tiranës dhe këshilli bashkiak i saj nuk kanë asnjë kompetencë që të vendosin tarifë për një shërbim që nuk e ofron Bashkia e Tiranës. Bashkia e Tiranës paguan për shërbimin që merr për trajtimin e mbetjeve të veta.

Po e përmbledhim edhe një herë Tiranën dhe me këtë rast edhe raportin.

Sipas raportit të përpiluar jetëgjatësia e fushës së Sharrës ishte parashikuar edhe një herë deri në vitin 2015. Pra, kjo përcaktoi edhe faktin pse në vitin 2015 kryetari i Bashkisë së Tiranës i është drejtuar me një shkresë Ministrisë së Mjedisit ku i kërkonte asistencë nga një subjekt privat për trajtimin e mbetjeve në Bashkinë e Tiranës, gjë, në fakt, që nuk u zgjidh menjëherë, sepse u desh një vit që të vinim të një propozim i pa kërkuar nga koncesionari.

Sa i përket procedurave të koncesioneve në përputhje me legjislacionin në fuqi sa i takon koncesioneve, impianti i Tiranës, siç ju thashë tërësisht investim privat, është kontratë koncesionare që nuk kërkon mbështetje financiare, por i referohet modelit financiar *pay for use*, i cili parashikon që i gjithë investimi do të kryhet nga koncesionari, i cili do të operojë për 30 vjet dhe në fund të periudhës 30- vjeçare ky aset do t'i kalojë Bashkisë së Tiranës,

Qeverisja qendrore e ka mbështetur në formën e transfertave Bashkinë e Tiranës në procesin e menaxhimit të mbetjeve me qëllim që kjo e fundit të mund të ushtrojë këtë përgjegjësi të vetën. Sipas kontratës koncesionare procedura për përzgjedhjen nga supervizori kryhet nga koncesionari, pasi edhe pagesa e supervizorit, sikundër u pohua edhe në këtë komision hetimor nuk është një pagesë që bëhet nga buxheti i shtetit, por nga vetë koncesionari. Nuk ka pasur ndryshim të kuotave të kësaj kontrate, ka pasur vetëm ndryshim të emrit, dhe kompania zotëruese nuk ka ndryshuar, kompania holandeze është e njëjta, me të njëjtat të dhëna, me të njëjtin NIPT, me të njëjtën adresë dhe gjithçka tjetër.

Në lidhje me mbetjet e Durrësit nuk është amenduar kontrata e Tiranës, sepse nuk ka qenë nevoja, se kjo kontratë në pikën 2.2 përcakton se me qëllim rritjen e rentabilitetit maksimizimin e investimeve të koncesionarit, i cili ka të drejtën të marrë dhe të furnizohet me mbetje edhe nga njësi vendore të qarqeve të tjera, ose persona të tretë privatë ose publik,

për aq sa kjo nuk e cenon përmbushjen e detyrimeve dhe sasisë së mbetjeve urbane që koncesionari ka sipas kësaj kontrate.

Kështu që në rastin e Durrësit ku analizuam hollësisht emergjencën mjedisore që kishte kjo bashki, atë se çfarë ishte duke ndodhur me Porto Romanon, por më tej ne kemi dëshmitarë vetë sidomos të gjithë ata që e shfrytëzojnë plazhin e gjirit të Lalëzit se sa protesta ka pasur nga banorët e zonës dhe se për sa kohë ky problem mbeti i pazgjidhur. Pra, kërkohej një zgjidhje pa dyshim, duhej një zgjidhje urgjente e situatës dhe sot Bashkia e Durrësit ka eliminuar tërësisht fushën e mbetjeve të Porto Romanos, një fushë e shndërruar në eko park që inaugurohet së shpejti dhe mbetjet e veta i depoziton 44 kilometër larg vendndodhjes së vet në Sharrë përkundrejt tarifës 29 euro për ton. Aktualisht mund të themi se projekti është në fazën e ndërtimit dhe të operimit, pasi, duhet pasur parasysh që Tirana është e përbërë nga impiantet për prodhimin e energjisë, do të ndërtoheshin dy të tilla; nga landfilli i mbetjeve urbane, nga landfilli i inerteve, nga landfilli i hireve, impianti i trajtimi të ujërave të ndotura, impianti i diferencimit për riciklim dhe e gjithë infrastruktura mbështetëse.

Tarifa 29 euro për ton është një çmim mesatar i ponderuar, që është vendosur pas një studimi të mirëfilltë. Çmimet mesatare të ponderurara janë instrumente financiare, që përdoren për t'i dhënë një kurbë sa më të zbutur një koncesioni dhe për të mos e goditur atë më vonë, në momentin që do të nisë incenerimi.

Pra, të gjitha këto impiante janë impiante të përpunimit të mbetjeve, që funksionojnë në bazë të piramidës dhe në bazë të përputhjes së plotë me të gjitha direktivat e BE-së. Procesi nis nga kolektimi i mbetjeve, pra nga mbledhja e mbetjeve që bëjnë bashkitë, te ndarja e tyre, te seleksionimi, te nxjerrja në proces të riciklimit të mbetjeve, që janë të riciklueshme, deri te shkatërrimi i mbetjeve përmes incenerimit, nga i cili përfitohet edhe energji elektrike.

Kështu që, impiantet e trajtimit të mbetjeve janë komplekse dhe të integruara dhe nuk janë thjesht inceneratorë, sikundër është përdorur qëllimisht fjala incenerator, me kastin për ta zvogëluar sa më shumë të jetë e mundur rrethin e të gjitha funksioneve që kryejnë këto impiante.

Sugjerimet e fundit që kemi dhe që po ia bëj me dije publikut, natyrisht ia vendosim në dispozicion edhe Kuvendit të Shqipërisë, ky hetim, sikundër u tha, ishte kompleks. Ndërkohë, mënyra e zhvillimit të tij tregoi qartësisht nevojën që ne kemi për ta riparë ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore”, një ligj i vitit 2002, mjafton vetëm kaq për të kuptuar që në 20 vjet qasjet kanë ndryshuar, sigurisht edhe legjislati duhet të performojë sipas qasjeve.

Ky ligj nuk i qëndron më kohës. Ai nuk lidhet absolutisht me reformën në drejtësi, një reformë, e cila një ndër synimet kryesore që pati (besoj na takon ta themi këtë me të drejtën e mbështetësve kryesorë dhe propozuesve të kësaj reforme) ishte pikërisht largimi i politikës nga drejtësia, jo në kuptimin formal, por në kuptimin substancial, mbi të gjitha. Ligji, sikundër lexohet sot, nuk garanton mosshkeljen e parimit të rëndësishëm kushtetutës të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe ky është cedimi më i rëndë, në fakt, i këtij ligji, që natyrisht ligjvënësi do të duhet të reagojë përmes rishikimit të këtij ligji, natyrisht duke rikonfirmuar të drejtën kushtetuese, që parasheh neni 87 për ngritjen e komisioneve hetimore. Opozitat gjithmonë janë mbajtur si ato që e gëzojnë dhe në favor të të cilave duhet vendosur kjo e drejtë, por ama ligji duhet të jetë i tillë, që ta vendosë ai mekanizmin për mbrojtjen e parimeve të rëndësishme kushtetuese dhe jo vota që jepet në Kuvendin e Shqipërisë, për miratimin e ngritjes së komisioneve hetimore, një votim që është qartësisht politik, i lidhur me kushtet dhe rrethanat e një momenti të caktuar, por që në mënyrë absolute nuk mund të garantojë respektimin e parimeve të rëndësishme mes së cilave më i rëndësishmi është ai që ka të bëjë me mënyrën si funksionojnë të tri pushtetet, si funksionojmë ne në raport me ekzekutivin dhe me pushtetin gjyqësor, si balancohemi me këto pushtete gjatë ushtrimit të veprimtarisë sonë të përditshme si të zgjedhur.

Këtij raporti ne do t'i bashkëngjisim edhe të gjitha provat dokumentare, procesverbalet dhe të gjitha ato çfarë ne kemi administruar në këtë komision hetimor. Të gjitha këto do t'i kërkojmë Kuvendit t'ia vërë në dispozicion prokurorisë, për arsyen që neni 77, paragrafi 2, i Kushtetutës parashikon se përfundimet e raporteve nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila vlerëson sipas procedurës ligjore.

Ne besojmë që në sjelljen tonë edhe në këtë raport, edhe përgjatë zhvillimit të punës nga ana e këtij komisioni hetimor, i jemi përmbajtur aq sa mundnim respektimit të parimeve të rëndësishme kushtetuese të cituara më se një herë në këto raporte. Pikërisht, nëse duam që ta konfirmojmë këtë në mënyrë të pamundur për t'u vënë në dyshim, të gjitha këto përfundime, së bashku me të gjithë dokumentacionin që do t'i bashkëngjitet këtij procesverbali, që është dokumentacioni i administruar nga ky komision apo gjatë zhvillimit të hetimeve, do t'i kërkojmë Kuvendit që t'ia vejë në dispozicion Prokurorisë së Posaçme, SPAK-ut, në mënyrë që ajo të mund të ushtrojë detyrën e vet, duke shpresuar që i gjithë informacioni tanimë është i siguruar dhe ngelet vetëm të bëhen përfundimet konkrete sa nga prokuroria, ashtu edhe nga gjykata, duke i dhënë fund abuzimit të aktorëve politikë me çështje në proces që rëndom i përdorin për të hedhur baltë ndaj njëri-tjetrit dhe për të kërkuar për të errësuar arsyen e opinionit publik në lidhje me tema të rëndësishme.

Ju faleminderit, sërish për vëmendjen!

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Unë do ta kufizoj veten nga bërja e komenteve pas raporteve përfundimtare, pasi kemi pasur mjaftueshëm kohë të gjithë për ta thënë mendimin tonë në këtë komision.

Para se të kalojmë në votim, do të doja të miratojmë procesverbalet e datave: 8, 9, 11, 14, 15, 16, 17, 21, 22, 23 dhe 25 shkurt, që na kanë ardhur me *e-mail*, ku ka pasur shumë ngarkesë prej dëshmive të gjata gjatë ditës.

Dua të falënderoj stafin e Kuvendit për punën që kanë bërë për zbardhjen e procesverbaleve, që ne t'i kishim para fundit të këtij komisioni!

Dua të hedh, së pari, për votim raportin e prezantuar nga deputetët e opozitës, nga Partia Demokratike në këtë komision. Kujtoj edhe një herë që raporti është 120 faqe, i gjithë do t'i dorëzohet SPAK-ut, ku disa kallëzime janë bërë, por do të bëhet njëkohësisht edhe një kallëzim i madh i plotë për të gjithë personat e përfshirë.

Kush është pro raportit të opozitës? Kundër? Abstenim?

Fatkeqësisht, nuk miratohet.

Lidhur me raportin e prezantuar nga zonja Felaj, si nënkryetare e komisionit që përfaqëson mendimin e maxhorancës, kush është pro? Kundër? Abstenim?

Ky është raporti i shumicës në këtë komision. Do t'i kërkoj stafit të Kuvendit që t'i vendosë të dyja raportet bashkë në një dokument, duke reflektuar mendimin e shumicës dhe të pakicës në këtë komision.

Në emër të Partisë Demokratike i bëj edhe një herë thirrje SPAK-ut për t'i administruar të gjitha provat që kanë dalë nga ky komision, por njëkohësisht edhe kërkesat specifike që bëra. Fatkeqësisht, deputetët e këtij komisioni nuk dolën përtej bindjeve të tyre politike dhe fatkeqësisht pati mbrojtje politike deri në momentin e fundit.

Ju uroj të gjithë kolegëve punë të mbarë në komisionet e tyre respektive!

Shpresojmë që në hetimet e ardhshme të kemi më shumë sukses!

MBYLLET MBLEDHJA